



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**“Komunikim dhe Marketing Digjital”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu Durrës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.asoc.dr. Ramadan Çipuri
2. Prof.asoc.dr. Holta Heba

Nëntor 2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “ Universiteti “Aleksandër Moisiu Durrës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr.482, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 22, date 30.03.2021 / MASR me shkresën Nr. 1954/1 Prot., datë 11.05.2021.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr. 282, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	I parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE/10 PAK Viti akademik 2022-2023
18	Numri i studentëve:	61 student 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” (KMD) ofrohet nga Departamenti i Marketingut (DM), në Fakultetin e Biznesit (FB), Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD). Ky program studimi është miratuar fillimisht në vitin 2018, me Urdhër të MASR Nr.482, datë 27.07.2018, në përfundim të të cilit lëshohet “Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital.”

Konform kuadrit ligjor mbi arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, programi u riorganizua gjatë vitit 2021, si program studimi i ciklit të parë Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital. Riorganizimi u miratua nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë me shkresën Nr. 396 Prot. datë 30.03.2021.

Qëllimi i programit të studimit Bachelor “Komunikim dhe Marketing Digjital” është të përgatisë profesionistë dhe drejtues me kualifikimin e duhur dhe me njohuritë e thelluara në fushën e marketingut dhe komunikimit digjital, duke iu përgjigjur kushteve të ekonomisë së tregut.

Objektivat kryesore formuese të programit të studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” janë të përgatisë profesion

istë me kualifikimin e duhur dhe me njohuritë e mjaftueshme në fushën e marketingut, komunikimit digjital dhe mediave sociale; të zhvillojnë aftësinë për të ndërtuar dhe vlerësuar raporte ekonomike dhe marketing; të njihen dhe të aftësohen në njohjen e sistemit marketing në nivel ndërkombëtar.

Kohëzgjatja e programit është 3 vite akademike, të ndarë në 6 semestra, me 180 kredite (ECTS), përkatësisht me 60 kredite/vit dhe 1500 orë në vit.

Ky proces akreditimi është i pari që ndodh në lidhje me këtë program.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i programit të studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” nisi punën për vlerësimin duke u njohur fillimisht me materialet dokumentare të vendosur në sistemin e ASCAL. Koordinatori i programit ndau përmes platformës dokumentet e nevojshme thuajse për të gjitha pikat që vlerësohen në program, me një numër të zgjeruar evidencash.

Nën koordinimin e ekspertës së caktuar nga ASCAL, u planifikua vizita në institucion në datën 15 dhe 16 qershor 2022.

Gjatë vizitës u realizuan takimet me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, me Përgjegjësën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të raportit të paraqitur, me anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, me studentët e këtij programi studimi nga të tre vitet akademike, me përfaqësues të sekretarisë mësimore të fakultetit, me përfaqësues që mbulojnë sektorin e karrierës, alumnit dhe komunikimit. Më tej u zhvilluan takime me përfaqësues të Drejtorisë së kurrikulës dhe standardeve të cilësisë, me përfaqësues të sektorit të burimeve njerëzore, me përfaqësues të sektorit të planifikimit dhe monitorimit të projekteve, si edhe u vëzhguan mjediset në funksion të këtij programi (auditorë, laboratorë, shërbimet për studentë, etj.), u vizitua biblioteka, ku u panë nga afër mundësitë që ofron ajo për studentët e këtij programi studimi.

Në përfundim të vizitës u zhvillua edhe një takim përmbledhës me përgjegjësën e departamentit të Teknologjisë së Informacionit.

Anëtarët e stafit akademik dhe administrativ me të cilin zhvilluam takime ishin të gatshëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të lindura gjatë procesit të hulumtimit të dokumentacionit të paraqitur, si edhe dorëzimit në kohë të evidencave shtesë të kërkuara gjatë vizitës në institucion.






# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Statuti i UAMD thekson se ky universitet mbështetet në parimin se arsimiti i lartë është i mirë dhe përgjegjësi publike, duke patur si mision ndër të tjera të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të angazhimit ndaj njeriut, kulturave e çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me individin dhe komunitetin; të përgatisë profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UAMD, Neni 58, pika 1</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Referuar evidencave të dokumentuara nga Institucioni, mund të themi se ky program studimi është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Ai mbështetet në statutin dhe Planin Strategjik të UAMD, por edhe në Planin Strategjik të Departamentit të Marketingut.</p> <p><i>Evidenca 2 - Statuti i UAMD-së, neni 4, 59, 61, 62</i>  <i>Evidenca 3 - Rregullore e UAMD-së, nenet 41, 43, 44</i>  <i>Evidenca 1 - Plani Strategjik i UAMD-së 2020 – 2025, fq. 6 pika 1&amp;4, fq 13</i>  <i>Evidenca 4 - Plani Strategjik i Departamentit Marketing 2021-2025, fq2</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin që shpjegon qëllimin, objektivat dhe përmbajtjen e këtij programi studimi, konstatojmë se ai përputhet me qëllimet dhe misionin e UAMD. Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” bazohet në misionin strategjik, qëllimet dhe objektivat strategjike për zhvillimin e institucionit.</p> <p>Referuar qëllimit dhe objektivave të programit, mund të themi se ato përputhen me parashikimet e statutit të UAMD, ku përcaktohen qëllimet dhe misioni i institucionit, të cilët mes të tjerash theksojnë se UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, si dhe të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar e ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Evidenca 2 - Statuti i UAMD-së, neni 4, 59, 61, 62</i>  <i>Evidenca 3 - Rregullore e UAMD-së, nenet 41, 43, 44</i>  <i>Evidenca 1 - Plani Strategjik i UAMD-së 2020 – 2025, fq 6 pika 1&amp;4, fq 13</i>  <i>Evidenca 4 - Plani Strategjik i Departamentit Marketing 2021-2025, fq2</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD është tashmë një nga institucionet e arsimit të lartë të konsoliduar për sa i përket eksperiencës në këtë fushë. Vetë FB ka nisur aktivitetin që nga viti 2006, dhe ka një eksperiencë të gjatë në administrimin e proceseve që karakterizojnë këto njësi. Ai zotëron përvojë, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga DB u konstatua se trupa akademike përbëhet nga një staf i kualifikuar,</p>



	<p>që përmbush detyrimet ligjore në raport me titujt akademik dhe gradat shkencore. Personeli akademik i aktivizuar është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. Nga 11 anëtarë të personelit akademik efektiv, 4 prej tyre janë të kategorisë profesor, pesë janë lektorë dhe dy të tjerë janë asistent lektorë. Ndërkohë, planit mësimor dhe evidencave që tregojnë titullarët e lëndëve, rezultojnë se mbi 70% e këtij programi studimi mbulohet nga personeli akademik i fushës përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 5 - Stafit Akademik i Departamentit Marketing që prej vitit 2013 – 2014</i>  <i>Evidenca 6 - Lektorët me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe lëndët KMD 2018 – 2022 &amp; Lektorët me fusha specifike.</i>  <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”</i>  <i>Evidenca 4 - Plani Strategjik i Departamentit Marketing, fq 3, fq 4, pikat e forta</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Pasi vlerësuam dosjen e programit të studimit dhe dokumentacionin në tërësi të paraqitur nga institucioni, GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njesisë Kryesore, konkretisht Fakulteti i Biznesit.</p> <p>KMD është i fokusuar në fushën e marketingut dhe menaxhimit, gjë kjo që është në përputhje të plotë me emërtimin dhe fushat akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Biznesit (FB) dhe Departamentit të Marketingut.</p> <p>Gjithashtu, DM ofron edhe programet e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim Marketing” dhe Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”. Kjo u mundëson studentëve të ciklit të parë për këtë program studimi që të kenë vazhdimësi studimesh brenda të njëjtës fushë.</p> <p>Ndërkohë në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ky program studimi është i regjistruar me numër identifikimi DR2136200903 Datë 22.10.2020.</p> <p><i>Evidenca 8 - Memo Kodifikimi i programeve) vendim nr.26</i>  <i>Evidenca 9 - Tabela e kodifikimit të programeve në UAMD, nr77</i>  <i>Evidenca 10 - Analiza e lidhjes se ciklit bachelor KMD me programet master</i>  <i>Evidenca 11 - Vërtetim Regjistrimi i Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë</i>  <i>Evidenca 12 - Suplement diplome BA KMD</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mbështetur në evidencat e paraqitura në dosje, por edhe në vizitën e zhvilluar në institucion, rezultojnë se UAMD ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Vetë programi i studimit KMD është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, fushën e veprimtarisë së tij, dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së UAMD, si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. Referuar evidencave dhe vizitës së zhvilluar pranë institucionit, mund të themi se UAMD, njësi kryesore dhe njësi bazë që ofrojnë këtë program studimi kanë përvojën dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi të kësaj natyre. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në KMD përputhet me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë në të cilat ofrohet.</i></p> <p><b>Kështu, konstatojmë se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</b></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

**Standardi I.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Referuar informacionit të mbledhur gjatë vizitës në institucion, por edhe nga evidencat që shoqërojnë raportin e vlerësimit të brendshëm vihet re se njësia bazë që e ofron këtë program studimi bashkëpunon ngushtësisht për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit edhe me njësitë e tjera brenda institucionit. Secila prej këtyre njësive ka një përshkrim të detajuar të punës që kryen dhe midis tyre rezultojnë të ketë një bashkëpunim efektiv.</p> <p>Ky bashkëvendim vihet re në pothuajse të gjitha zyrat e institucionit, të cilat angazhohen me detyrat administrative, të tilla si Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike (Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës) për çështje të publikimeve, aktiviteteve, të dhënave të punësimit dhe alumnit etj, me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë për çështjet e kurrikulave dhe ngarkesave mësimore, me Drejtorinë e Planifikimit, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë për aplikimet në kuadër të projekteve dhe ndjekjen e tyre, si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të huaj dhe vendas, me Drejtorinë e Administrimit financiar për çështjet financiare etj.</p> <p>Bazuar në evidencat, por edhe nga vizita që zhvilluam në institucion u vu re se komunikimi zyrtar mes njësive dhe strukturave brenda institucionit bazohet në Rregulloren për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD.</p> <p><i>Evidenca 13 - Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD,</i>  <i>Evidenca 14 - Organigrama UAMD</i>  <i>Evidenca 15 - Rregullore e Fakultetit të Biznesit, nenet 7 –8, nenet 10 – 25</i>  <i>Evidenca 2 - Statuti i UAMD-së, neni 8, 24, kreu II</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion një listë të gjerë me marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj. Për t'u vlerësuar është se në këtë listë, përmes evidencave të ndryshme, dokumentohet bashkëpunimi sa në nivel institucional me universitete të ndryshme në vend, rajon dhe Evropë, por edhe në nivel fakulteti dhe departamenti, të cilat shërbejnë për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve. Në këtë drejtim, Departamenti i Marketingut rezultojnë se ka nënshkruar 9 marrëveshje bashkëpunimi me kompani/institucione kombëtare me qëllim kryerjen e praktikave profesionale, por edhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta ku mund të angazhohen studentët e Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital".</p>



	<p>Përfitimet nga këto marrëveshje u pohuan edhe nga anëtarët e personelit akademik dhe studentët me të cilët zhvilluam takime gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Evidenca 16 - Marrëveshjet e bashkëpunimit të Departamentit Marketing</i>  <i>Evidenca 17 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenca 18 - Raport vjetor UAMD 2020-2021, fq 41 – 44</i>  <i>Evidenca 4 - Plani Strategjik i Departamentit Marketing, pika 5</i>  <i>Evidenca 19 - Marrëveshje bashkëpunimi UAMD</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Ngjashëm me atë që thamë në kriterin pararendës vihet re se institucioni i përmbush më së miri kërkesat e këtij kriteri. Referuar evidencave të paraqitura, vetëm gjatë vitit 2021-2022 janë formalizuar 90 (nëntëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi me homologë të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me partnerë kombëtarë. Ndërkohë ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare me synim bashkëpunimin në një sërë fushash.</p> <p><i>Evidenca 16 - Marrëveshjet e bashkëpunimit të Departamentit Marketing</i>  <i>Evidenca 17 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenca 20 - Lista e marrëveshjeve bilaterale për shkëmbime</i>  <i>Evidenca 21 - Lista e Mobiliteteve të Stafit &amp; Studenteve</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Po, nga vizita që zhvilluam në institucion mësuam se kjo praktikë zhvillohet në mënyrë të përvitshme, më së shumti përmes analizës vjetore që departamenti bën në fund të çdo viti akademik. Në këtë raport përfshihet i gjithë aktiviteti akademik dhe kërkimor e shkencor i tij me tregues të detajuar mbi procesin mësimor, aktivitetet e departamentit, promovimin e stafit akademik, metodologjinë e ndarjes së ngarkesave mësimore etj. Krahas evidencës së paraqitur, Drejtuesi i njësisë bazë na njohu me shembuj konkretë të këtij raporti, i cili ndër të tjera analizon edhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Për t'u vlerësuar në këtë drejtim është bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në organizimin e aktiviteteve akademike, si konferenca apo projekte të ndryshme. Të gjitha këto ndihmojnë personelin akademik që të sjellin tek studentët njohuri të përditësuara varësisht dinamikave që shoqërojnë këtë sektor.</p> <p><i>Evidenca 22 - Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020 fq.63</i>  <i>Evidenca 23 - Call for Papers - ISCOIM 2022</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Referuar dokumentacionit të paraqitur në dosje dhe të dhënave të mbledhura nga vizita në institucion u konstatua se ka një bashkëpunim dhe bashkërendim të kënaqshëm të punëve, detyrave dhe ndarjes së përgjegjësive midis njësive të ndryshme brenda institucionit në funksion të këtij programi studimi. Gjithashtu, ka një numër të lartë marrëveshjesh bashkëpunimi të realizuara nga UAMD për partneritete sa në rrafshin akademik, por edhe nga njësia kryesore dhe bazë, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</i></p> <p><i>Varësisht këtyre të dhënave, mund të themi se institucioni i përmbush plotësisht kriteret e këtij standardi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		





				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi#II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Plani mësimor i dokumentuar së bashku me dosjen e këtij programi tregon se elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital ofrohet si program studimi me kohë të plotë të organizuar me 180 ECTS dhe me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, të ndarë në gjashtë semestra.</p> <p>Ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 për “elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Organizimi i këtij programi në nivel institucional parashikohet në Rregulloren e UAMD, Statut dhe Rregullore të FB.</p> <p><i>Evidenca 24 - Plani mësimor bsc KMD Riorganizim 2021</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bachelor në KMD ka objektiva të përcaktuara qartë në lidhje me formimin e studentëve, të tilla si të përgatisë profesionistë me kualifikimin e duhur dhe me njohuritë e mjaftueshme në fushën e marketingut, komunikimit dhe mediave sociale.; Të zhvillojnë aftësinë për të ndërtuar dhe vlerësuar raporte ekonomike dhe marketing; Të njihen dhe të aftësohen në njohjen e sistemit marketing në nivel ndërkombëtar; Të pajisë studentin me njohuritë teorike mbi shkencën e marketingut duke i integruar këto njohuri me praktikën; Të pajisë studentin me kompetencat e duhura operative-praktike për analizën e realitetit të biznesit dhe jo vetëm në të cilin operojnë aktorët e tregut; Të pajisë studentin me aftësi tekniko-metodologjike, për të seleksionuar, përpunuar informacion e për ta përdorur në realitetin e tregut në Shqipëri dhe më gjerë; Të krijojë hapësirat e nevojshme për kualifikimin e mëtejshëm akademik dhe profesional të studentëve, duke zgjeruar mundësitë e tyre për përshtatjen me tregun e punës; Të aftësohen në përzgjedhjen e teknikave të duhura për menaxhimin e mediave; Të mësojnë si të ekzaminojnë sistematikisht tema të ndryshme mbështetur në baza të</p>

	<p>forta teorike. Të zhvillojnë aftësinë e zhvillimit të fushatave marketing.</p> <p>Ndërkohë sipas rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” synohet përgatitja e specialistëve të marketingut, për të analizuar dhe vlerësuar situata të ndryshme të fenomeneve e dukurive të fushës së biznes-bërjes dhe menaxhimit të tyre, si edhe përgatitja e specialistëve për fushën e Marketingut si dhe përgatitja e kualifikimit shkencor për studime master të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca 25 - Objektivat e Programit te studimit Bsc KMD</i>  <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital, neni 2</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, konkretisht, plani mësimor, korniza konceptuale e programit, programet e lëndëve të prezantuara përmes sylabuseve, suplementit të diplomës dhe rregullores së programit, u konstatua se Programi i studimit KMD organizohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Lëndë Bazë - 20%</li> <li>B. Lëndë Karakterizuese - 51.1%</li> <li>C. Lëndë Ndërdisciplinore - 13.3%</li> <li>D. Lëndë Plotësuese – 8.8%</li> <li>E. Detyrime Përmbyllëse – 3.3%</li> </ul> <p>Ndarja e mësipërme është në përputhje me parashikimet ligjore në këtë drejtim.</p> <p><i>Evidence 24 - Plani mësimor bsc KMD Riorganizim 2021</i>  <i>Evidenca 26 - Raport praktika profesionale</i>  <i>Evidenca 27 - Kurikul dhe plani mesimor bsc KMD Riorganizim 2021</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar rregullores dhe planit mësimor të programit, Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të tretë. Kohëzgjatja për kryerjen e praktikës profesionale përcaktohet në nenin 18 të Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”. Ngarkesa e shprehur në kredite për praktikën profesionale në këtë program studimi është 5 kredite dhe detyrimeve përmbyllëse Provim Formimi / Diplomë, Viti 3, Semestri 2, 6 ECTS.</p> <p><i>Evidence 24 - Plani mësimor bsc KMD Riorganizim 2021</i>  <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Kjo fushë nuk aplikohet për këtë program studimi pasi UAMD nuk është IAL me status të veçantë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 përqind.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, duhet thënë se ky program studimi përbën një risi për këtë fushë, pasi nuk ofrohet gjerësisht në ofertën akademike të IAL-ve shqiptare. Referuar planit mësimor, por edhe përmbajtjes së sylabuseve të lëndëve, vlerësojmë se ky program është ndërthurje e dy profileve, marketing dhe komunikim, që përta i përket mënyrës se si është organizuar, mendojmë se tenton të mbulojë nevojat në tregun e punës. Nga takimi që</p>

	zhvilluam me drejtuesin e departamentit dhe personelin akademik mësuam se për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare, janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare nga vende të zhvilluara.						
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Përsa i përket kodifikimit të programit të studimit, drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore u shprehën se në pritje të një unifikimi nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, UAMD duke u bazuar në direktivat ndërkombëtare, ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve. Për programin e studimit bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” kodi i përcaktuar është UAMD-BCH-60414-KMDI.  <i>Evidence 9 - Tabela e kodifikimit të programeve në UAMD</i> <i>Evidence 8 - Memo Kodifikimi i programeve</i>						
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Kjo fushë nuk aplikohet.						
<b>Konkluzione</b>	<i>Nga sa më sipër, konstatojmë se elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë dhe përgjithësisht në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve; Programi i studimit ka një mision dhe objektive të qarta që synojnë formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, duke ofruar njohuri të përparuar në fushën e studimit; janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite; ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e detyrimeve përmbyllëse; mbështetet në udhëzimet e MAS dhe kuadrit ligjor në fuqi për formën e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimit të institucionit; si edhe ka ngjashmëri brenda parashikimeve të kriterëve respektive me programet e ngjashme në IAL-të shqiptare.  <i>Nisur mbi këto gjykime, vlerësojmë se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i></i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht			X
Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht					
		X					

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe	Fakulteti i Biznesit, si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimeve Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” ka në përbërje të tij 6 departamente të cilat janë:  <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Financë-Kontabilitet;</li> <li>2. Departamenti i Menaxhimit;</li> </ol>



akreditimin.	<p>3. Departamenti i Marketingut;</p> <p>4. Departamenti i Shkencave Ekonomike;</p> <p>5. Departamenti i Turizmit;</p> <p>6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës Ekonomike.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ngarkesa që mbulohet përgjatë një viti akademik nga stafi efektiv është gjithmonë më e madhe se ajo e stafit akademik të ftuar ose me kohë të pjesshme, por duke ruajtur përgjithësisht edhe raportin 70% me 30% .</p> <p>Mbështetur në evidencat e paraqitura mund të themi se si njësia kryesore, po ashtu edhe ajo bazë përgjegjëse për këtë program studimi i përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><i>Evidenca 31 - Organigrama Departamenti i Marketingut 2022</i>  <i>Evidenca 32 – Organigrama FB</i>  <i>Evidenca 33 - Memo 70% Ngarkesës te Brendshëm</i></p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>FB dhe DM rezulton se ka angazhuar personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. Në strukturën e personelit ndihmës akademik në UAMD, për çdo laborator kompjuterik ka të punësuar një personel ndihmës akademik ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratorit të caktuar. Referuar jetëshkrimit të këtij personeli, të dokumentuar në dosjet e ruajtura në sektorin e burimeve njerëzore, por edhe atyre të paraqitura në evidencën 35, mund të themi se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për Bachelor në KMD kanë angazhuar personel, profili i të cilit përputhet me punën e ngarkuar dhe që ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca 35 - CV e Stafit Ndihmës Akademik</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sipas rregullores së departamentit, Koordinatorit i Programit të Studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” është përgjegjës për punën dhe përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik; kujdeset për implementimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në këtë program studimi; nxit dhe ndjek krijimin e marrëveshjeve në funksion të këtij programi studimi; mbikëqyr procesin e kryerjes së praktikave profesionale; organizon vlerësimin e brendshëm të programit të studimit dhe kryen detyra të tjera që i përcakton përgjegjësi i Njesisë Bazë.</p> <p><i>Evidenca 37 - Rregullore e Departamentit Marketing, neni 15</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Organizimi i Fakultetit të Biznesit si njësi kryesore dhe i Departamenti i Marketingut si njësi bazë është brenda kritereve dhe normave të parashikuara nga kuadri ligjor. Përsa i përket stafit akademik efektiv në këtë departament, ai i përmbush detyrimet ligjore. Institucioni garanton ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit përmes detyrave dhe përgjegjësive që i njeh koordinatorit të programit.</i></p> <p><i>Në këto kushte, vlerësojmë se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1917 786 1989">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="794 1917 1026 1989">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1034 1917 1265 1989">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1989 786 2022"></td> <td data-bbox="794 1989 1026 2022"></td> <td data-bbox="1034 1989 1265 2022">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					




<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në evidencat e paraqitura në dosjen e aplikimit për akreditimin e këtij programi, por dhe në vizitën që zhvilluam në mjediset e IAL-së mund të themi se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin Bachelor në KMD i disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor i programit Bachelor në KMD përmban të gjithë elementët e kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Ky program studimi realizohet në 3 vite akademike, të ndarë në 6 semestra gjatë të cilëve studenti fiton 180 kredite ETCS. Procesi mësimor organizohet në gjashtë semestra të rregullt me kohëzgjatje 16 javë dhe me ngarkesë mesatare 30 kredite për semestër (3 vite akademike), ku çdo semestër përmban 6 ose 7 lëndë me frekuentim.</p> <p>Plani Mësimor përmban informacionet e nevojshme për lëndët, për orët që studenti kalon në auditor dhe orët e punës së pavarur jashtë auditorit. Për sa i përket syllabuseve, përmes takimeve në institucion me studentët konstatuam se këta të fundit informohen nga lektorët e lëndëve përkatëse mbi objektivat dhe qëllimet, temat dhe mënyra e vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 3 - Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni 66</i>  <i>Evidenca 24 - Plani mësimor bsc KMD Riorganizim 2021</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Këto të dhëna janë të shpjguara qartë në rregulloren e programit të studimit dhe në statutin e IAL-së. Statuti parashikon edhe procedurën e vendosjes së kriterëve të pranimit, duke ia lënë këtë kompetencë departamenteve që dëshirojnë të vendosin kriteret shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve, në përputhje me specifikat e programeve të studimit.</p> <p>Në statut, neni 74 shpjegon mënyrën e transferimit, njohjes dhe njësimit të diplomave.</p> <p><i>Evidenca 42 - Procedura Transferimeve</i>  <i>Evidenca 3 - Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni.62</i>  <i>Evidenca 2 - Statuti e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Neni 62, 74</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion informacione të nevojshme mbi programet e lëndëve, informacione për leksionet, praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Syllabuset për secilën lëndë janë të plota dhe të pajisura me të gjithë elementët e nevojshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- emrin e disiplinës,</li> <li>- emrin e lektorit të lëndës,</li> <li>- numrin e krediteve (ETCS),</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin e orëve mësimore të ndara leksion dhe seminar,</li> <li>- llojin e lëndës,</li> <li>- semestrin kur do të zhvillohet,</li> <li>- disiplinën e formimit karakterizues,</li> <li>- qëllimet dhe objektivat,</li> <li>- mënyrën e vlerësimit,</li> <li>- literaturë bazë dhe atë të sugjeruar,</li> <li>- kalendarin mësimor,</li> <li>- Kërkesat/udhëzimet për respektimin e kodit të etikës.</li> </ul> <p>Të dhënat e mësipërme janë në përputhje me përcaktimet e të VKM-së nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.8.</p> <p><i>Evidenca 43 - Syllabuset e lëndëve BSc. KMD</i>  <i>Evidenca 24 - Plani mësimor bsc KMD Riorganizim 2021</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>DM zhvillon një analizë vjetore të programit të studimit në çdo fund viti akademik.</p> <p>Ndërkohë, sipas rregullores së UAMD, syllabusi hartohet nga lektori përgjegjës jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të semestrit, dhe miratohet tek përgjegjësi i departamentit përkatës pas marrjes së pëlqimit të përgjegjësit të grupit mësimor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup.</p> <p>Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit u vu re se DM në periudha të ndryshme ka bërë ndryshime të kurrikulës, me synimin për ta përmirësuar atë, brenda hapësirave prej 20% të parashikuara nga ligji i Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidenca 46 - Kurikula para riorganizimit KMD</i>  <i>Evidenca 27 - Kurikula dhe plani mësimor bsc KMD Riorganizim 2021</i>  <i>Evidenca 47 - Relacion Ndryshimet në Syllabuset të Programit Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital".</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se FB dhe DM pranë UAMD disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Kjo mundësohet përmes rregulloreve në nivel institucional, njësie kryesore, njësie bazë dhe programi studimi. Programi KMD përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Ky program përmban informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe njësimin e studimeve, si edhe syllabuse të detajuar me të gjithë elementët e nevojshëm. Në funksion të përmirësimit dhe përditësimit të programit, DM zhvillon analiza vjetore në fund të çdo viti akademik.</i></p> <p><b><i>Kriteret e parashikuara në këtë standard përmbushen plotësisht.</i></b></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					



<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga verifikimi i planit mësimor, syllabuseve dhe rregullores së programit të studimit Bachelor në KMD, vihet re se emërtimi, përmbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike, u mundëson studentëve njohuri teorike dhe praktike për kalimin sa më me lehtësi nga auditorët e universitetit në tregun e punës. Kurrikula është organizuar mirë në një mënyrë të tillë që lëndët e njëpasnjëshme plotësojnë njëra-tjetrën, duke iu mundësuar studentëve njohuri solide sa nga aspekti profesional, po aq edhe për vijimësinë e studimeve në ciklet pasrëndëse.
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Referuar planit mësimor, rregullores së programit dhe syllabuseve të lëndëve, konstatojmë se lëndët në programin Bachelor në KMD janë shpërndarë në mënyrë të tillë që u përgjigjen kompetencave të propozuara të programit me synimin e arritjes së rezultateve të të nxënit që u korrespondojnë këtyre kompetencave.  Lëndët e kurrikulës së programit të studimeve Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” janë organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë pothuaj të përafërt përgjatë semestrave.
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Mbështetur në planin mësimor, suplementin e diplomës dhe në syllabuset e lëndëve vihet re se struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Në fakt, gjatë takimeve që zhvilluam në institucion, drejtuesi i njësisë bazë dhe anëtarët e personelit akademik na bënë me dije se në organizimin e kurrikulës janë mbështetur në disa modele të universiteteve të huaja, pasi kjo degë nuk është ofruar deri para disa vitesh në IAL-të shqiptare.
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nisur nga mënyra se si është organizuar kurrikula e programit të studimit bachelor në KMD, por edhe përmbajtja e lëndëve e pasqyruar në syllabuset e tyre, përsa i përket ndarjes së veprimtarive dhe raportit midis formimit teorik dhe praktik, mundëson një arritje të objektivave të parashikuar në këtë kriter.  Rregullorja e këtij programi studimi parashikon gjithashtu edhe konvertimi në kredite UsCr, gjë kjo që ndihmon gjithashtu jo vetëm në lehtësimin e integritit të studentëve të diplomuar pranë UAMD-së në tregun e punës, por edhe në mobilitet dhe transferimin e studimeve në vende të tjera.  <i>Evidenca 10 - Rregullore e Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”</i> <i>Evidenca 53 - Lista e mobiliteteve të studenteve dhe stafit akademik në FB 2016 - 2022 dhe Mobility agreement shembull</i>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe	Rregullorja e UAMD shpjegon përmbajtjen dhe rregullat për përditësimin e syllabusit të lëndëve. Syllabusi hartohet nga lektori përgjegjës jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të semestrit, dhe miratohet tek përgjegjësi i departamentit përkatës pas marrjes së pëlqimit të përgjegjësit të grupit mësimor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup.  Kjo praktikë na u konfirmua edhe nga personeli akademik me të cilin u

ndihmëse të viteve të fundit.	takuam në mjediset e institucionit. <i>Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 62</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Siç e përmendëm edhe më sipër, kurrikula e programit Bachelor në KMD është organizuar duke u mbështetur më shumë në modelet e institucioneve të arsimit të lartë jashtë vendit, e përditësuar gjithashtu edhe me dinamikat e zhvillimeve të fushës. Nga mënyra se si është organizuar plani mësimor dhe brendia e lëndëve, mund të themi se ato i ndihmojnë studentët që të integrojnë mirë konceptet teorike me ato praktike, çka garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Ndërkohë vihet re se DM ka bërë edhe përmirësime duke futur lëndë të reja ose duke hequr lëndë të mëparshme brenda kufijve të lejuar nga ligji.  <i>Evidenca 50 - Ndryshimet ne kurikul para dhe pas KMD</i> <i>Evidenca 47 - Relacion Ndryshimet ne Syllabuset të Programit Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital"</i> <i>Evidenca 48 - Njoftim e-maili per ndryshim syllabusi 03.10.2022</i> <i>Evidenca 43 - Syllabuset e Lëndëve BSc. KMD</i>		
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Po, mënyra e organizimit të përmbajtjes së programit dhe harmonizimi i lëndëve i ndihmon studentët dhe u mundëson atyre vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.  Lëndët teorike krijojnë një bazë njohurish të qëndrueshme që u mundëson atyre studimet në ciklet pasrendëse, ndërsa nga ana tjetër, lëndët që lidhen me praktikën profesionale, por edhe me zhvillimet teknologjike përbëjnë një bazë të mirë në përgatitjen e studentëve për integrimin në tregun e punës.		
<b>Konkluzione</b>	<i>DM për programin e studimit Bachelor në KMD i ka organizuar njohuritë në lëndë që plotësojnë gamën e njohurive të nevojshme për studimet në ciklet e mëtejshme dhe për integrimin e studentëve në tregun e punës. Shtrirja e lëndëve në semestra ndjek një rend logjik, nga formimi bazë dhe i përgjithshëm, e deri tek lëndët karakterizuese dhe ato që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave hulumtuese e shkencore, por edhe në zhvillimin e aftësive praktike në ushtrimin e profesionit.</i> <i>Për sa më sipër, kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>





**Standardi IL5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Mbështetur mbi evidencat që parashikojnë procedurën për përmbajtjen e programit të studimit dhe kërkesat në vijim të këtij kriteri, por edhe nga takimet që u zhvilluan në institucion me drejtuesit e njësisë bazë dhe anëtarët e personelit akademik, u vu re se diskutimet për të bërë këto ndryshime nisin me analizën vjetore që bëhet në fund të cdo viti akademik, për të vijuar më tej me konsultime më të gjera që përfshin aktorë të tregut, partnerë universitar në vende të ndryshme që ofrojnë programe të ngjashme, por edhe studentë të diplomuar e që aktualisht ushtrojnë profesionin në kompani të ndryshme. Në këtë pikë theksojmë se si UAMD, po aq edhe njësia bazë dhe ajo kryesore kanë një numër të lartë marrëveshjesh bashkëpunimi me partnerë universitar, por jo vetëm, eksperiencat me të cilët kanë shërbyer për përmirësimin e ofertës akademike të Bachelor në KMD, për të qenë sa më pranë nevojave të tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, një element i rëndësishëm në këtë proces është edhe vlerësimi i kërkesave që vijnë nga studentët për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion u njohëm edhe me një procedurë të ndjekur në këtë drejtim, gjë që e bën të qartë këtë praktikë.</p> <p><i>Evidenca 57 - Kërkesë nga studentët për futjen e lëndëve të reja në kurrikulën e Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital"</i>  <i>Evidenca 58 - Studimi i tregut në lidhje me BSC - KMD</i>  <i>Evidenca 59 - Pyetësor për studentët e Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital", "</i>  <i>Evidenca 60 - Miratim kërkesë për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital</i>  <i>Evidenca 61 - Relacion rreth riorganizimit të programit të studimit Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital"</i>  <i>Evidenca 50 - Ndryshimet ne kurikul para dhe pas KMD</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizitat e zhvilluara në institucion u vu re praktika që përdoret për mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me Alumnin, të diplomuarit ndër vite. Nga takimi me anëtarët e personelit akademik të DB u njohëm edhe me angazhimin e disa prej të diplomuarve në aktivitetin e departamentit, të cilët në momente të caktuara kanë kontribuar me idetë e tyre për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Nga ana tjetër, zyra e angazhuar me të diplomuarit përmes takimeve që zhvillon me ta mbledh opinionin e tyre në lidhje me përmirësimet e mundshme që mund të bëhen në këtë drejtim. Anëtarët e personelit akademik me të cilët u takuam në institucion pohuan se sugjerimet e studentëve të diplomuar bëhen pjesë e diskutimeve të analizës vjetore të departamentit, duke i pasqyruar ato në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e</p>	<p>Po, kjo u vu re edhe në evidencat që shoqërojnë RVB, por edhe në takimin e zhvilluar në institucion me grupe të ndryshme. Sic e theksuam edhe më sipër, FB dhe DB ka një bashkëpunim të ngushtë me rrjete profesionistësh,</p>

fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	shoqata dhe institucione publike e private, me të cilët këshillohet për dinamikat që shoqërojnë industrinë respektive.		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Pas verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës së zhvilluar në institucion, mund të themi se për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, DM konsultohet dhe merr parasysh propozimet e institucioneve partnere, por edhe të diplomuarit e vet. DB i pasqyron këto si pjesë të përshtatjes së programeve lëndore, përmirësimin e infrastrukturës në dispozicion të mësimdhënies dhe praktikave mësimore, trajnimeve jashtë kurrikulare, etj.</i></p> <p><i>Nga sa më sipër, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Referuar rregullores së këtij programi studimi, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë atë përbëhen nga këta komponentë mësimorë: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; studim individual (studim a punim relacionesh, detyrash a projektesh; përgatitje për provim; përgatitje e temës së diplomës dhe veprimtari të tjera si praktika profesionale, praktika në terren ose stazh pranë subjekteve publike apo private.</p> <p>Shpjegimi i formave të mësimdhënies gjendet sa në formatin e syllabuseve, po aq edhe në veprimtaritë formuese të programit, planin mësimor, paketat e</p>



	<p>praktikës për programin, strategjinë e zhvillimit të programit, etj.</p> <p><i>Evidenca 10 - Rregullore e Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital"</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në këtë pikë, vlen të theksojmë se UAMD ka një infrastrukturë të mirë përsa u përket mjediseve të kampusit ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në KMD. Auditorët dhe laboratorët në funksion të programit janë të pajisur me pajisjet e nevojshme teknologjike, gjë që u mundëson anëtarëve të personelit akademik të përdorin mënyra bashkëkohore dhe metoda alternative të mësimdhënies, duke iu përgjigjur nevojave të studentëve për një përgatitje sa më profesionale. Nga vizita në institucion konstatuam se në Fakultetin e Biznesit funksionojnë dy laboratore bashkëkohorë, të cilët përdoren nga lektorët për kryerjen e orëve të veçanta që kanë nevojë për një kombinim të teorisë me praktikën.</p> <p><i>Evidenca 64 - Foto të auditorëve, bibliotekës, sallave të konferencave, laboratorëve etj.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se ka një bashkëpunim të kënaqshëm midis Zyrës së Burimeve Njerëzore me njësitë bazë për trajnimin e stafit akademik rreth temave të ndryshme. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luante edhe Qendra e Edukimit të Vazhduar, e cila shpesh herë kishte organizuar trajnime sipas nevojave për anëtarët e personelit akademik, veçanërisht për ata të kategorisë asistent lektor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Po, kjo gjë u konstatua jo vetëm përmes evidencave të vëna në dispozicion nga Institucioni, por edhe nga studentët me të cilët u takuam në mjediset e IAL-së. Ata pohuan se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në KMD është kompetent në shpjegimin e njohurive, dhe i hapur për diskutime dhe interaktivitet me studentët. Studentët pohuan se personeli akademik ka një nivel të lartë komunikimi me ta jo vetëm gjatë orëve mësimore, por edhe në nevojat për praktika apo angazhime të tjera profesionale jashtë auditorit.</p> <p>Ndërkohë, nga verifikimi i CV-ve dhe dosjeve të personelit akademik pranë zyrës së burimeve njerëzore, konstatuam se anëtarët e këtij departamenti kanë formimin e duhur akademik për fushat që mbulojnë.</p> <p><i>Evidenca 6 - Lista e lektoreve që kanë dhënë mësim Bsc KMD &amp; Lektore me Fusha Specifike</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Edhe në këtë pikë u vu re se departamenti merr në konsideratë vlerësimin e studentëve për përmirësimin e formave të mësimdhënies. Sugjerimet nga ana e studentëve mblidhen përmes një rubrike të posaçme në pyetësorin që ata plotësojnë në fund të çdo semestri, para provimeve finale. Ky pyetësor lidhet më shumë me vlerësimin e performancës së pedagogut të lëndës, por departamenti i ka kushtuar vëmendje sugjerimeve që vijnë pikërisht nga kjo rubrikë. Kjo tregon një vëmendje të shtuar të njësisë bazë ndaj një nevojë që duhej të plotësohej përmes instrumenteve të ndryshme nga NJSBC në nivel institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë</p>	<p>Nga ana tjetër, për t'u vlerësuar është praktika që ndiqet për përmirësimin e formave të mësimdhënies duke përfshirë këtu të gjithë anëtarët e</p>

<p>kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>departamentit. Kjo ndodh sa përmes trajnimeve që bëhen në lidhje me metodat bashkëkohore të mësimdhënies, po aq edhe me leksionet e hapura që zhvillohen me praninë e të gjithë anëtarëve të departamentit.</p> <p>Ndërkohë, siç e thamë edhe mësipër, një vëmendje e shtuar i kushtohet personelit akademik të kategorisë asistent lektor, të cilët trajnohen vazhdimisht nga Qendra e Edukimit në Vazhdim me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p>Një eksperiencë e mirë në këtë drejtim që ndihmon stafin akademik të departamentit është edhe eksperiencia e përfuar nga pjesëmarrësit nga disa vende në konferencën ISCOIM që zhvillon departamenti, e cila është shumë specifike për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 65 - Procesi i vlerësimit të personelit akademik nga studentët</i>  <i>Evidenca 66 - Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët - final CleanScore</i>  <i>Evidenca 67 - Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se DM në programin Bachelor në KMD ka angazhuar një staf të kualifikuar, me ekspertizën e duhur për lëndët që ofrojnë, dhe përdorin forma të mësimdhënies në përputhje me kriteret ligjore, në mjedise të përshtatshme me njohuritë teorike dhe praktike. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</i></p> <p><i>Nga sa më sipër, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale u panë përmes disa formave, sa nga evidencat e dokumentuara nga institucioni, po aq edhe nga mënyra se si aplikoheshin duke pyetur studentët, personelin akademik dhe për përfaqësuesit e sekretarisë mësimore.</p> <p>Rregullorja e programit parashikon format dhe kriteret e vlerësimit të studentit, të cilat përcaktohen, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në</p>	<p>Vlerësimi i një lënde bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Provimin e ndërmjetëm;</li> <li>b) Provimin përfundimtar;</li> <li>c) Detyrat e kursit (projekt individual ose në grup).</li> </ul>



syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 ajo maksimale.		
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga takimi i zhvilluar me studentë u vu re se ata ishin të informuar për kriteret dhe mënyrat e testimit të njohurive dhe aftësive profesionale. Studentët pranuan se informohen mbi përmbajtjen e syllabusit të çdo lënde që në orën e parë të mësimin.		
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Në lidhje me këtë kriter, sugjerojmë që mënyra e vlerësimit e përdorur në nivel institucional duhet të përshtatet më mirë me natyrën e këtij programi studimi. Kjo për vetë faktin se ka disa lëndë me karakter praktik, në vlerësimin e të cilave mund të përdoren mënyra të ndryshme vlerësimi, si detyra kursi, projekte individuale ose në grup. Sugjerojmë që vlerësimi me 90% të dy provimeve (final dhe të ndërmjetëm) dhe vetëm 10% të detyrave të kursit, duhet të rishikohet duke e përshtatur me programin e studimit. Në këtë pikë mund të ketë një nivel më të lartë autonomie të titullarit të lëndës.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Ndërkohë, nga verifikimet e bëra rezultoi se personeli akademik informohet në mënyrë periodike në lidhje me opinionin e studentëve në përfundim të çdo semestri për seksionet që ai mbulon. Ai ka autonomi të plotë për përzgjedhjen e mënyrës dhe metodave të mësimdhënies që mendon si më të përshtatshme për të arritur objektivat e synuara nga lënda që ofron, gjë kjo e pranuar gjerësisht prej tyre gjatë takimit të zhvilluar në institucion.  <i>Evidenca 3 - Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i> <i>Evidenca 15 - Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i> <i>Evidenca 68 - Rregullore provimeve Fakulteti Biznesit</i> <i>Evidenca 70 - Syllabus model BSC KMD</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD ka përcaktuar kritere dhe mënyra të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e Institucionit, të gjitha këto , bëhen publike studentëve.</i> <i>Në këtë pikë, sugjerimi ynë është për një rishikim të mënyrës vlerësimit të dijeve jo vetëm sipas rregullores që e organizon atë në nivel institucional, por duke e përshtatur me natyrën e programit të studimit. Kjo do të ndihmojë në një vlerësim më objektiv të njohurive të studentëve për lëndët të cilat kanë më shumë karakter praktik dhe që mund të shlyhen përmes punës praktike individuale ose në grup.</i> <i>GVJ vlerëson se ky standard përmbushet kryesisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		<b>X</b>	

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i	Rregullorja e UAMD e parashikon syllabusin si programin e lëndës në të

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>cilin parashikohen objektivat e lëndës, literatura e detyrueshme e miratuar në departament, literatura e sugjeruar për informacion shtesë, temat, orët për leksione dhe seminare, kohëzgjatjen e kursit dhe mënyrën e vlerësimit. Ai dhe rregullat e provimit u prezantohen dhe shpjegohen studentëve nga lektori në orën e parë të zhvillimit të kursit.</p> <p><i>Evidenca 2 – Rregullore UAMD, Neni 62</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Po, nga verifikimet e bëra rezultojnë se institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. UAMD ka një marrëveshje bashkëpunimi si pjesë e projektit Clean Score të mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.</p> <p>Ndërkohë, aktualisht FB përdor për studentët platformën e sekretarisë digjitale ESSE3 të ngritur nga RASH, e cila ka në funksion sistemin elektronik Pitagora.</p> <p><i>Evidenca 74 - Marrëveshja Clean – Score</i> <i>Evidenca 75 - Clean Score Trajnim</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Syllabuset e dokumentuara me dosjen e këtij programi tregojnë qartë pasqyrimin e mënyrës së vlerësimit të çdo kursi në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatorë. Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentit realizohet përgjatë gjithë semestrit. Kjo është e përcaktuar në rregulloren e UAMD- së në nenin 68, në rregulloren e FB-së në nenin 59, në rregulloren e programit Bachelor në nenin 19 të saj si dhe në rregulloren e provimeve të FB-së.</p> <p><i>Evidenca 3 - Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i> <i>Evidenca 68 - Rregullore provimeve Fakulteti Biznesit</i> <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i> <i>Evidenca 41 - Rregullore provimesh FB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregullorja e UAMD parashikon mënyrën e zhvillimit të provimeve, komunikimit të tyre dhe komentet e mundshme që mund të kenë studentët.</p> <p>Personeli akademik duhet të përgatisë së paku 4 teza të ndryshme provimi sipas formatit të njësisë bazë të cilat nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të kursit, për të marrë sqarimet e duhura.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brena afateve të mësipërme. Ndërkohë zbatimi i të gjithë këtyre procedurave u pohua edhe nga grupi i studentëve me të cilët zhvilluam takim në mjediset e institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brena afateve të mësipërme. Ndërkohë zbatimi i të gjithë këtyre procedurave u pohua edhe nga grupi i studentëve me të cilët zhvilluam takim në mjediset e institucionit.</p> <p><i>Evidenca 3 - Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i> <i>Evidenca 68 - Rregullore provimeve Fakulteti Biznesit</i> <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i></p>



	<i>Evidenca 41 - Rregullore provimesh FB</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. <b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Sipas rregullores së UAMD, studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin përmes një kërkesë drejtuar drejtuesit të njësisë kryesore jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Kur kërkesa e tij refuzohet, ai/ajo njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Kur miratohet, dekani ngre një komision Ad-Hoc për rishikimin e tezës nëse kursi mbulohet nga vetë departamenti.</p> <p>E gjitha kjo procedurë dhe shumë detaje të tjera parashikohen në rregulloren e institucionit, duke garantuar procedura të rregullta dhe transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p> <p>Vetë studentët pohuan se kjo praktikë është funksionale në rastet që ka ankesa për mënyrën e zhvillimit të provimit dhe vlerësimit të njohurive të tyre.</p> <p><i>Evidenca 2 – Rregullore UAMD, Neni 62</i>  <i>Evidenca 68 - Rregullore provimeve Fakulteti Biznesit</i>  <i>Evidenca 7 - Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i>  <i>Evidenca 41 - Rregullore provimesh FB</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se DM, për programin Bachelor në KDV ka miratuar dhe zbaton rregullore të qarta në lidhje me format e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, duke i formalizuar ato përmes syllabuseve të lëndëve. UAMD përdor një sistem elektronik vlerësimi të njohur nga studentët dhe personeli akademik. Procesi i vlerësimit të ankimimeve të studentëve është i formalizuar dhe funksional. Në këto kushte, GVJ vlerëson se kriteret e këtij standardi <b>përbushen plotësisht.</b></i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Nga vlerësimi që i bëmë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, si plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve, por edhe nga rregullorja e programit të studimit, mund të themi se ky i fundit ndihmon në thellimin e njohurive teorike, duke zhvilluar edhe aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve përmes punës në laboratorët e pajisur me pajisje teknologjike bashkëkohore. Nga ana tjetër, nga intervistat në institucion me studentët, GVJ konstatoi se zhvillimi aftësive të veçanta të studentëve përvijohet edhe përmes përfshirjes së tyre në detyra dhe projekte sipas interesit që ata shfaqin. Për t'u vlerësuar ishte fakti se studentët treguan për shumë projekte që zhvilloheshin në grup, gjë kjo që nxiti zhvillimin e aftësive të kësaj natyre, të rëndësishme për kushtet e sotme të tregut të punës.

*Evidenca 43 - Syllabuset e Lëndëve BSc. KMD*



	<i>Evidenca 27 - Kurikul dhe plani mesimor bsc KMD Riorganizim 2021</i>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Instrumentet e cilësisë së aplikuara në UAMD, ndër të tjera parashikojnë vlerësimin e personelit akademik nga ana e studentëve, përmes një pyetësoi të posaçëm që plotësohet në javën që i paraprin provimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Paçka se nuk ka një pyetësor të dedikuar vlerësimit të lëndës, gjatë takimit të zhvilluar me personelin akademik na u bë me dije se vlerësimi i studentëve në këtë drejtim mbledhet përmes një rubrike të posaçme në këtë pyetësor, ku kërkohen opinionet dhe sugjerime të tyre.</p> <p>Ndërkohë, referuar syllabuseve të lëndëve, në to përshkruhen qartësisht kompetencat e parashikuara për t'ju dhënë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë. Krahas lëndës së praktikës, edhe në lëndët e tjera rezultojnë se ka shumë projekte që realizohen në këtë formë, sa në mënyrë individuale, po aq edhe në grup. Infrastruktura në funksion të këtij programi studimi u mundëson studentëve të zhvillojnë në praktikë njohuritë teorike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar me anëtarët e personelit akademik dhe studentët, ata u shprehën se detyrimet e studentëve në raport me kursin përkatës shpjegohen në mënyrë të qartë, sa për angazhimin individual, po aq edhe për punën e zhvilluar në grup. Përgjithësisht, këto detyra / projekte bazohen në zgjidhjen e problematikave / çështjeve të caktuara që miratohen nga personeli akademik i lëndës në javët e para të mësimin. Në këto njohuri mund të përfshijmë vendimmarrjet në planifikimin dhe menaxhimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të bizneseve si edhe përdorimit të informacionit nga tregu në funksion të kësaj vendimmarrjeje. Kjo duket se garantohet nëpërmjet zhvillimit të një kombinimi të balancuar të lëndëve bazë të detyrueshme, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Një aspekt i rëndësishëm në këtë pikë ishte vendimmarrja e përbashkët midis pedagogëve dhe studentëve për mënyrën e zhvillimit të disa prej zërave të lëndës, më së shumti ato me karakter praktik. Këto tema vendoseshin në grup, me sugjerimet e të dy palëve, duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë të menduarit kritik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për sa i përket mundësive për praktikim të njohurive teorike në lëndët e kësaj natyre, si "Aplikim Kompjuteri", "Metodat e kërkimit Shkencor", "Mediat Sociale" UAMD zotëron ka vënë në funksion të studentëve dy laboratorë të pajisur me pajisjet e nevojshme teknologjike.</p> <p>Krahas evidencave, gjatë vizitës në institucion, drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, por edhe pedagogët dhe studentët pranuan se ka pasur disa leksione të hapura, workshope dhe aktivitete të tjera që i kanë ndihmuar studentët për të zhvilluar aftësitë e punës në grup, apo për të krijuar një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore.</p> <p>Studentët që studiojnë në programin Bachelor në KMD kanë mundësi të përfitojnë nga marrëveshjet që institucioni ka nënshkruar me disa organizata/sipërmarrje/institucione publike dhe private. Kjo u verifikua përmes listës së marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni, por edhe</p>

	bashkëpunimit efektiv që ekziston midis tyre në interes të konsolidimit të njohurive që duhet të marrin studentët.		
	<i>Evidenca 27 - Kurikul dhe plani mesimor bsc KMD Riorganizim 2021</i> <i>Evidenca 73 - Foto të laboratorëve</i> <i>Evidenca 77- Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021</i> <i>Evidenca 78 - Analiza Vjetore Departamenti Marketingut fq 57</i> <i>Evidenca 77- Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021</i>		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ vlerëson se DM përmes programit Bachelor në KMD ka kryer një punë të kënaqshme për marrëdhëniet që ndërton me studentët. Kjo nis që nga dita e parë e zhvillimit të një lëndë, e cila nis me prezantimin e syllabuseve, njohjen e mënyrës së vlerësimit dhe me detyrimet e studentëve, dhe vazhdon përgjatë të gjithë periudhës së studimeve, ku vë në dispozicion një infrastrukturë funksionale, marrëveshje me institucione/organizata/sipërmarrje publike e private, me qëllim ofrimin e njohurive të qëndrueshme teorike dhe profesionale për studentët.</p> <p>Kështu, GVJ vlerëson se kriteret e këtij standardi <b>përmbyshen plotësisht</b></p>		
<b>Shtkalla e përmbyshjes së standardit</b>	<b>Përmbyshet pjesërisht</b>	<b>Përmbyshet kryesisht</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedura e detyrimeve përmbyllëse për studentët e “Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”, është e parashikuar në rregulloren studimeve UAMD, rregulloren e fakultetit dhe në rregulloren e programit të studimit. Nga takimi që zhvilluam me studentët, mësuam se këto rregullore u bëhen atyre me dije që në javën e parë të regjistrimit në vitin e parë, përmes ditëve të orientimit. Këto procedura u shpjegohen atyre edhe nga anëtarët e departamentit, përgjegjës për këshillimin e studentëve sipas viteve.</p> <p>Varësisht rregulloreve të mësipërme, për të marrë pjesë në provimin apo tezën e diplomës studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e tjera të kurrikulës. Ai mund të regjistrohet në këto detyrime vetëm pasi shlyerja e këtyre tyre konfirmohet nga sekretaria mesimore. Procedura e organizimit dhe e vlerësimit të provimit të diplomës pasqyrohet në rregulloren e diplomimit të FB.</p> <p>Njësia Bazë ju vë në dispozicion studentëve fushat e studimit që mbulon dhe listën e stafit akademik nga e cila ata duhet të përzgjedhin një udhëheqës i cili do të asistojë në vazhdimësi në përgatitjen e temës së diplomës. Studenti paraqet pranë Njesisë Bazë kërkesën e tij me shkrim në lidhje me temën e përzgjedhur dhe udhëheqësin e tij ashtu si paraqitet në nenin 14, aneksi B i rregullores së diplomimit të FB-së.</p> <p><i>Evidenca 79 - Rregullore Diplomimi Vendim senati</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë</p>	<p>UAMD ka një rregullore të posaçme për diplomimin, ku parasheh të gjitha procedurat e nevojshme. Përveç pedagogut udhëheqës për gjatë gjithë vitit që</p>



<p>studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>iu ka vënë në dispozicion studentëve, Njësia Bazë bën publike në ueb-in dhe stendën informative të fakultetit: a. Listën e stafit akademik me kohë të plotë, kontaktet zyrtare dhe fushat specifike të studimit që secili prej tyre mbulon; b. Listën e studentëve që kanë të drejtë të paraqiten në mbrojtjen e një punimi diploma dhe udhëheqësin përkatës; c. Kriteret dhe standardet e një punimi diplome në "Bachelor".</p> <p>Studentët e vitit të tretë që ishin të pranishëm në takimin e zhvilluar në institucion u shprehën se kishin një udhëheqës për punimin e diplomës, i cili u kishte vënë në dispozicion një udhëzues të detajuar për përgatitjen e punimit, si edhe i asistonte ata përmes disa seancave metodologjike të planifikuara në një ditë të javës.</p> <p><i>Evidenca 79 - Rregullore Diplomimi Vendim senati</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbështetur në evidencat e paraqitura nga institucioni, detyrimet përmbyllëse për studentët e ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Biznesit zhvillohen në dy forma: a) Në rastin kur student i ka një mesatare mbi notën 7, student i shlyen detyrimet përmbyllëse me përpilimin e temës së diplomës dhe mbrojtjen e saj përpara një komisioni të posaçëm; dhe b) në rastin kur student i ka një mesatare nën notën 7, student i shlyen detyrimet përmbyllëse duke zhvilluar provimin për mbylljen e studimeve. Studentët e çdo programi studimi, që nuk marrin tezë diplome, i përfundojnë studimet me provim të përgjithshëm përfundimtar. Nëse programi i studimit përmban në kurrikulën e tij një kurs praktike, ky shërben si kurs diplomimi për ato kurrikula që nuk kanë tezë diplome. Drejtuesi i Njësies Bazë, për çdo program propozon ngritjen e një komisioni për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik.</p> <p><i>Evidenca 79 - Rregullore Diplomimi Vendim senati, neni 11</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar rregullores se diplomimit, puna për realizimin e diplomës realizohet nga student i dhe nën udhëheqjen e pedagogut. Rregullorja detyron udhëheqësin të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave të udhëheqjes së diplomës. Ai duhet të këshillojë dhe të mbikëqyrë punën e studentit sipas standardeve metodologjike të kërkuara.</p> <p>Udhëheqësi shqyrton dhe vlerëson në vazhdimësi ecurinë e punës së studentit, teksa ky i fundit është i detyruar të raportojë udhëheqësin në mënyrë periodike për punën e realizuar.</p> <p><i>Evidenca 79 - Rregullore Diplomimi Vendim senati, neni 5</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni ofron mjedise dhe mundësi të kënaqshme për studentët gjatë punës së tyre kërkimore në lidhje me detyrat dhe temat e diplomës.</p> <p>Ambientet e FB, laboratorët mësimore dhe kërkimore, biblioteka etj. janë në dispozicion të studentëve edhe jashtë orareve mësimore kur këta të fundit kërkojnë t'i përdorin për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve mësimore ose dhe projekteve kërkimore.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm</p>	<p>Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti dhe miratohet nga dekani. Komisioni</p>



<p>përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë.</p> <p>Vlerësimi i temës së diplomës bëhet me sistem 1000 pikësh i cili konvertohet në note në sistemin shqiptar dhe në shkronjë në sistemin amerikan.</p> <p><i>Evidenca 79 - Rregullore Diplomimi Vendim senati, neni 12</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Po, Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria.</p> <p><i>Evidenca 12 -Suplement diplome BA KMD</i></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UAMD ka një rregullore të posaçme për arkivimin e dokumentacionit. Sipas saj, dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL-ja për një periudhë të pacaktuar në hard-copy si dhe në databazën digjitale që disponon.</p> <p>Dokumentacioni i studentit ruhet në bazë të akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të rregulloreve përkatëse nga sekretaria mësimore. Njësia kryesore krijon dosjen e studentit që në çastin e regjistrimit, dosje e cila pasurohet më tej me të dhëna në sistemin elektronik dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga sa më sipër vlerësojmë se institucioni ka një rregullore të posaçme për diplomimi, ku personeli akademik luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e studentit për të shkuar drejt fazës finale të diplomimit. Rregulloret parashikojnë qartësisht detyrat e personelit akademik dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Për sa i përket këtij kriteri, GVJ ka verifikuar se në lidhje me programin e studimit “Komunikim dhe Marketing Digjital”, UAMD ndjek procedura ligjore transparente për rekrutimin e stafit. Këtë gjë e verifikon Statuti i këtij universiteti, rregullorja e fakultetit, rregullorja e departamentit, rregullorja e Departamentit të Marketingut si dhe përgjigjet e pedagogëve përgjatë takimit. Pedagogët u pyetën për mënyrën se si janë rekrutuar në këtë program studimi dhe GVJ vërtetoi edhe njëherë se dokumentacioni dhe procedura për këtë proces është i saktë dhe plotëson kriterin ligjor.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, nga zyra e Burimeve Njerëzore, GVJ-së iu vu në dispozicion dokumentacioni i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Personeli i angazhuar në mësimdhënie ishte i kategorive profesor, lektor dhe asistent lektor. Po në lidhje me këtë program studimi, “Komunikim dhe Marketing Digjital”, personeli i angazhuar ka një nivel kualifikimi më të lartë se cikli i studimeve ku ishte i angazhuar, sikurse e kërkon edhe kriteri ligjor përkatës.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 87. Fakulteti i Biznesit, kriteret e vendeve të lira të punës</i>  <i>Evidenca 31. Organigrama Departamenti i Marketingut 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për këtë kriter, GVJ konfirmoi ngarkesën mësimore të personelit akademik që mbulon programin e studimit Komunikim dhe Marketing Digjital.</p> <p>Institucioni angazhon në varësi të nevojave staf akademik, i cili e mbulon ngarkesën mësimore përgjatë gjithë vitit akademik në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>Në UAMD, GVJ u njoh me procedurën që ndiqet çdo fillim viti për shpërndarjen e ngarkesës mësimore si dhe hartimin dhe dorëzimin e programeve të lëndëve nga çdo pedagog i angazhuar në vit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës, pas kërkesës sonë na u vu në dispozicion një nga rekrutimet më të fundit të personelit akademik (përfshirë të gjithë procedurën nga fillimi deri në fund).</p> <p>Gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë, por edhe nga personeli akademik i angazhuar për këtë program, na u bë me dije se ngarkesa e miratuar nga njësia bazë dhe fakulteti miratohej në dy semestra dhe monitorohej nga rektorati dhe zyrat përkatëse, në mënyrë që të respektoheshin standardet ligjore dhe ato cilësore të UAMD.</p> <p><i>Evidenca 31. Organigrama Departamenti i Marketingut 2022</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p><i>Evidenca 84. Orari me emra 2018-2022</i></p> <p>Departamenti I Menaxhim Marketingut e administron informacionin në lidhje me aktivitetin akademik dhe administrativ, sipas statutit dhe rregullores së fakultetit dhe njësisë bazë. Informacioni për stafin ruhet në disa zyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zyra e personelit dhe pagave</li> <li>- zyra e financës</li> <li>- njësia bazë.</li> </ul> <p>Për sa i përket dokumentimit të informacionit të stafit, GVJ konstaton se çdo informacion dokumentohet nëpërmjet planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës akademike, ngarkesës për kontributin institucional, ngarkesës. Gjatë takimeve me drejtuesin e njësisë bazë dhe dekanin e fakultetit të Biznesit, u bëmë me dije se dokumentet e stafit ruhen në departament dhe bëhen pjesë e analizës shkencore të departamentit.</p> <p>Detyrimet financiare dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit ishin të siguruar me korrektësi nga UAMD. UAMD siguron mbulimin me korrektësi të të gjitha detyrimeve financiare duke përfshirë edhe mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Rinovimi i kontratave me kohë të caktuar bëhej automatikisht bazuar në rekomandimin e përgjegjësit të departamentit dhe Dekanit të Fakultetit të Biznesit, gjithmonë kur performanca e personelit akademik është në nivelin që synon programi i studimit dhe UAMD.</p> <p><i>Evidenca 85. Vërtetim për kontributet e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor</i> <i>Evidenca 18. Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procesi i rekrutimit të personelit akademik në Fakultetin e Biznesit kryhet sipas akteve ligjore në fuqi si dhe të gjitha procedurave që janë të pasqyruara në rregulloret e Institucionit.</p> <p>Në takimin që GVJ realizoi me pedagogët e këtij departamenti, ata pohuan të gjithë procesin e rekrutimeve sikurse është e shprehur në dokumentacion.</p> <p>Në momentin që njësia bazë, por edhe Fakulteti i Biznesit ka nevojë për staf, shpallet konkursi për vende të lira pune, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi Administrimit dhe kryen publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Njoftimet për vende të lira pune dhe formularët e aplikimit publikohen dhe në faqen zyrtare të UAMD. Për këtë proces pranohen vetëm dosjet e aplikimit që vijnë në UAMD me anë të shërbimit postar. Ato protokollohen sipas rregullave në fuqi.</p> <p>Pasi janë pranuar dosjet, Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve fitues sipas përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi dhe Statutit të UAMD-së. Vlerësimi i dosjes së një aplikanti kalon në 2 faza: shqyrtim dosjeje dhe intervistë. Këto faza të ndara në përqindje ku 70% zë vlerësimi i dosjes dhe 30% intervista.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/mundesipunesimi">https://uamd.edu.al/mundesipunesimi</a> <i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i> <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p><i>Evidenca 2. Rregullore UAMD</i></p> <p>Institucioni garanton angazhimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik, që të jenë sa më pranë programit të studimit dhe me eksperiencë në tregun e punës, pasi ai e ka dhe të domosdoshme një staf të tillë, nisur edhe nga natyra e vetë programit të, “Komunikim dhe Marketing Digjital” i cili ka karakter shumë specifik.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor “Komunikim dhe Marketing Digjital” studentët kryejnë disa orë në laboratorët kompjuterike, me qëllim që të aplikojnë në praktikë ato njohuri të cilat i kanë mësuar teorikisht në auditor, të cilat u vijnë në ndihmë për të qenë sa më pranë tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 73. Foto të laboratorëve</i> <i>Evidenca 97. Ambiente të Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë konfirmuam se UAMD, mbështetur në bazën ligjore për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të personelit të angazhuar e plotëson këtë kriter.</p> <p>Sikurse na u rikonfirmua nga të dy drejtoritë, çdo vit akademik Departamenti i Menaxhim-Marketingut / Fakulteti i biznesit dorëzon pranë rektoratit të dhënat për angazhimin e personelit akademik të detajuar sipas kurseve, semestrit dhe programit të studimit.</p> <p>Ky proces ishte një nga detyrimet e raportimeve periodike në UAMD. Si pjesë e detyrimeve për raportimet periodike, të departamentit dhe fakultetit çdo vit akademik, të dhënat e grumbulluara administroheshin nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë e cila ka dhe detyrimin për monitorimin e zbatimin të ligjshmërisë nga ana e njërive bazë dhe kryesore të UAMD.</p> <p><i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i> <i>Evidenca 87. Fakulteti i Biznesit, kriteret e vendeve të lira të punës</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit u njohëm me partneritetet që UAMD ka me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe impaktin që kanë dhënë këto marrëveshje në zhvillimin e institucionit.</p> <p>Gjithashtu u njohëm me shumë veprimtari të përbashkëta shumë të rëndësishme për sigurimin e cilësisë, por edhe për zhvillimin e Universitetit të Durrësit, Aleksandër Moisiu. Në lidhje me këtë program studimi, njësia Bazë dhe Fakulteti i Biznesit si dhe UAMD-ja kanë bërë përpjekje për të ndihmuar studentët në lidhje me institucionet, bizneset apo kompanitë ku studentët do të zhvillojnë Praktikën Profesionale, duke ju vënë në dispozicion studentëve marrëveshjet e bëra prej tyre.</p> <p>Në kurrikulën dhe planin mësimor të Programit të Studimeve Bachelor “Komunikim dhe Marketing Digjital” janë të përfshira detyrimet përmblyëse të kryerjes dhe mbrojtjes së Praktikës Profesionale, të mbrojtjes së temës së diplomës si dhe provimit përfundimtar.</p> <p>Panairit i Punës &amp; Karrierës I-rë i organizuar nga Fakulteti i Biznesit në qershor të vitit 2021 dhe Panairit të Punës &amp; Karrierës edicioni II-të (prill 2022) ku kanë marrë pjesë mbi 200 biznese dhe institucione publike ka qenë një mundësi konkrete e kontakteve të drejtpërdrejta (nëpërmjet intervistave</p>

	dhe dorëzimit të CV) të studentëve me institucionet publike dhe private. <i>Evidenca 90. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit</i> <i>Evidenca 92. Foto Panairi i Punës Fakulteti i Biznesit</i> <i>Evidenca 25. Objektivat e Programit të studimit bsc KMD</i> <i>Evidenca 26. Raport praktika profesionale</i> <i>Evidenca 94. Tabela e Shperndarjeve të Temave Bachelor</i>		
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nisur nga raporti i GVB dhe nga takimet në institucion, por edhe pas konsultimit me programin e studimit, GVJ konstatoi se:  <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kohëzgjatja e Praktikës Mësimore është 3 muaj.</li> <li>- Pedagogu udhëheqës ushtron kontrole periodike pranë institucioneve/kompanive që studenti po zhvillon praktikën.</li> <li>- Në fund të praktikës dhe përpara mbrojtjes përfundimtar të praktikës mësimore, studenti praktikant ka për detyrë të dorëzojë pranë departamentit: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) formularin e vlerësimit të studentit nga pedagogu mbikëqyrës (Aneksi 1);</li> <li>b) formularin e vlerësimit (Vërtetim Praktike) të studentit nga mbikëqyrësi në kompani/institucion/organizatë (Aneksi 2);</li> <li>c) raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës (Aneksi 3).</li> </ul> </li> </ul> Praktika në këtë program studimi është konsideruar si një mundësi e mirë për sistemimin e studentëve në punë. Njësia Bazë dhe Fakulteti i Biznesit si dhe UAMD-ja u ka vënë studentëve në dispozicion të gjitha marrëveshjet, në mënyrë që studentët të ndihmohen për zhvillimin e praktikës profesionale.  <i>Evidenca 93. Draft Agjendë panairi i punës dhe i karrierës 2022</i> <i>Evidenca 26. Raport praktika profesionale</i> <i>Evidenca 16. Marrëveshjet e bashkëpunimit Dep. Marketingut</i> <i>Evidenca 125. Trajnime për studentët nga Kompani private</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se drejtuesit e njësisë bazë dhe fakultetit janë gjithnjë në përpjekje të vazhdueshme për t'u ardhur në ndihmë studentëve në lidhje me asistencën e nevojshme që i duhet studentit për të qenë sa më pranë tregut të punës. GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe takimet me GVB institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në mjedis me infrastrukturë të kompletuar dhe komode, të cilat janë të përshtatshme për këtë program studimi, duke qenë gjithnjë në përputhje me natyrën specifike të tij.</p> <p>Godina e re e Fakultetit të Biznesit ka përfunduar në 2018. Në këtë godinë gjendet edhe departamenti i marketingut. Kjo godinë është e ndërtuar sipas të gjitha standardeve bashkëkohore, duke krijuar kështu mjedis dhe mundësi të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik të programit Bachelor ka një zyrë të pozicionuar në këto ambiente, të cilën e ndan me 2 kolegë, ku secili prej tyre është i pajisur me tavolinën e punës, kompjuter dhe pajisjet ndihmëse si fotokopje, video projektor, kancelari të ndryshme etj. të pavarur. Stafit akademik i ka të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar veprimtarinë e tij.</p> <p><i>Evidenca 96. Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD</i>  <i>Evidenca 97. Ambiente të Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenca 73. Foto të laboratorëve.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe bazuar në dokumentet e GVB, GVJ konstatoi se ambientet mësimore ishin të pajisura me sisteme wireless, video projektorë të cilat krijojnë kushtet për realizimin me standarde të larta dhe cilësi të aktivitetit mësimor. Këta laboratorë kanë lidhje interneti, 20-30 PC me parametra të përshtatshëm dhe të kompletuar me programet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor dhe praktikat profesionale</p> <p>Departamenti i Menaxhim-Marketingut është i organizuar në grupe mësimore-kërkimore, të cilat orientojnë edhe angazhimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së departamentit. Programi Bachelor Komunikim dhe Marketing Digjital ka një përmbajtje të lëndëve nga të grupet mësimore-kërkimore. Grupe të cilat janë prezentë çdo ditë të javës në departament, për të suportuar maksimalisht studentët dhe njëri-tjetrin.</p> <p><i>Evidenca 97. Ambiente të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 96. Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së</i>  <i>Evidenca 73. Foto të laboratorëve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konfirmon se mjediset në dispozicion të programit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvajtje të procesit mësimor.</p> <p>Sallat kanë një akustikë të mirë tepër komode për zhvillimin e orës mësimore. Fakulteti i Biznesit, në ambientet e të cilit zhvillohet programi Bachelor “Komunikim dhe Marketing Digjital”, është i pajisur me ambiente modern, si laboratorë të informatikës, në të cilin zhvillojnë leksione të integruara me praktikën studentët e Marketingut.</p> <p>Theksohet fakti se, Laboratori me fjalën e fundit të teknologjisë, është ndërtuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, ku peshën kryesore të financimit e ka mbajtur kompania Crystal System e cila vazhdimisht ka</p>



	<p>integruar në praktikat e saj, studentë të Marketingut.</p> <p>Mjediset kanë ndriçim të mirë dhe të pajisura me sistem ngrohëse e ftohëse gjatë gjithë vitit. Janë funksionale.</p> <p><i>Evidenca 73. Foto të laboratorëve</i>  <i>Evidenca 72. Foto - Kendi Studentit</i>  <i>Evidenca 97. Ambiente të Fakultetit të Biznesit</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Klasat janë të pajisura me video projektor dhe me mundësi për të aksesuar sistemin wireless të internetit, që mund të nevojitet për zbatimin apo përmirësimin e procesit mësimor. Në klasa mund të përdoren mjetet audiovizuale, që janë të depozituara në departament dhe mund të ofrohen nga sekretaria e departamentit për të realizuar prezantime, detyra, projekte kursi. Pajisja e klasave me tabela, Whiteboard (e aplikuar vetëm në disa raste), Smartboard dhe wireless mundëson zhvillimin e mësimimit në kushte shumë të mira. Çdo zyrë, sallë, ambient i bibliotekës dhe ambient në dispozicion të studentëve është e pajisur me internet Ethernet Cable.</p> <p><i>Evidenca 73. Foto të laboratorëve</i>  <i>Evidenca 97. Ambiente të Fakultetit të Biznesit</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Standardi përmbushet plotësisht, pasi programi i studimit ka në dispozicion laboratorë me pajisje të kohëve më të fundit, të cilët e afrojnë studentin më pranë profesionit. Kushtet komode, Laboratorët dhe mjetet teknologjike janë një pikë e fortë e këtij program studimi, të cilat do ta afrojnë studentin më pranë profesionit dhe do ta zhdërvjelltojnë atë për punën e ardhshme.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p><b>Standardi IV.3</b></p> <p><b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi konfirmuam se pedagogët përdorin literaturë bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Komunikim dhe Digjital Marketing” iu ofron studentëve mundësinë e aksesimit të literaturës bazë dhe ndihmëse përmes 3 mjediseve biblioteke që ndodhen në mjediset e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Biblioteka qendrore e cila ndodhet në ambientet e godinës në Currila,</li> <li>- salla e bibliotekës së Fakultetit Biznesit dhe Fakultetit të Edukimit e cila është e vendosur në mjediset e godinës A e ndodhur në Spitalë.</li> <li>- biblioteka e Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike e vendosur në godinën B, Spitalë.</li> </ul> <p>Orari dhe shërbimi i ofruar nga stafi i bibliotekës është i përshtatshëm për nevojat e studenteve dhe pedagogëve. Mjediset e bibliotekave kanë kapacitete në tituj dhe pajisje si kompjuterë për të mundësuar plotësimin e kërkesave të tyre.</p>

	<p><i>Evidenca 98. Biblioteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i>  <i>Evidenca 99. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Pasqyrimi i përditësimit të literaturës së detyrueshme bëhet nga njësia bazë pasi kjo e fundit miraton këtë literaturë. Pas miratimit, ndryshimet pasqyrohen edhe në syllabusin e kursit.  Biblioteka është e abonuar në shumë revista shkencore.  Lista e paketave U-LIBRARY :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- -Academic Search Complete: databaza kryesore e revistave/periodekeve/librave/etj te dedikuar vetëm për arsimin e larte dhe kërkimin</li> <li>- Newspaper Source Plus</li> <li>- -Business Source Complete</li> <li>- Regional Business Neës Plus</li> <li>- -MasterFILE Complete</li> <li>- -Health Source: Academic &amp; Nursing Edition</li> <li>- Health Source: Consumer Edition</li> <li>- ERIC</li> <li>- -MEDLINE</li> <li>- -Etj.</li> </ul> <p><i>Evidenca 98. Biblioteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i>  <i>Evidenca 99. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e Programit të studimit Bachelor ne “Komunikim dhe Marketing Digjital” kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë, gjithashtu edhe akses ne platformën online.</p> <p>Bazuar në RVB, por edhe nga konstatimi në UAMD, GVJ konstatoi se biblioteka funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 3.2.2000, Neni 30, “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Biblioteka online ka krijuar mundësinë që të aksesohet më shumë informacion në lidhje me programin e studimit. Biblioteka e Universitetit “Aleksandër Moisiu” përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë: COBIB.AL</p> <p><i>Evidenca 98. Biblioteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i>  <i>Evidenca 99. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka në UAMD garanton literaturë kryesisht të viteve të fundit, tekste mësimore dhe plotësuese, në përputhje me kurrikulat mësimore.</p> <p>Numri i kopjeve për çdo titull varion nga 2-5 kopje mesatarisht, ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1- 2 kopje.</p> <p>Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik, (mbi 10000 tituj). Megjithatë, literatura nuk është e mjaftueshme në sasi, në raport me numrin e përdoruesve. Aktualisht në UAMD janë funksionale 3 biblioteka. Koleksioni i tyre përfshin burime që plotësojnë nevojat e të gjithë përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. Pasurimi i koleksioneve në përputhje me kurrikulat mësimore është i vazhdueshëm, por jo periodik, në varësi të</p>

	<p>mundësive buxhetore dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe dizertacioneve.</p> <p><i>Evidenca 98. Bibloteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i>  <i>Evidenca 100. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet akses i kufi i internetit, duke u dhënë kështu mundësi studentëve që të kërkojnë edhe në bibliotekën online. Çdo student/ pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për navigimin në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik.</p> <p><i>Evidenca 98. Bibloteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD u konstatua se ambientet e bibliotekës ofrojnë PC, ku kanë të instaluar programe të përshtatshme sipas profilit të studimit duke ju mundësuar studentëve leximin dhe studimin dhe realizimin e detyrave.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me programe të integruara bibliotekare: COBISS (sistemi bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Shqipëri), me një rol qendror në sistemin e katalogimit të përbashkët, në kërkimin e informacioneve bibliografike dhe në udhëheqjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë shqiptarë.</p> <p>Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik, me standarde ndërkombëtare.</p> <p>Regjistrimi, frekuentimi dhe shërbimi falas për të gjithë studentët dhe pedagogët e UAMD.</p> <p><a href="http://192.168.100.242/">http://192.168.100.242/</a>  <i>Evidenca 98. Biblioteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i>  <i>Evidenca 102. Rregullorja e Bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sikurse është evidentuar edhe nga evidencat e RVB Biblioteka është e organizuar në mënyrë të atillë që studentët të kenë gjithnjë akses sipas orarit të përshtatur me procesin mësimor.</p> <p>Biblioteka e UAMD funksionon në orarin 8.00-16.00 nga e hëna në të dielë. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në Web-in e universitetit.</p> <p>Studentet kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisiu" përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë: COBIB.AL.</p> <p><i>Evidenca 98. Biblioteka online</i>  <i>Evidenca 81. Foto Biblioteka UAMD</i>  <i>Evidenca 102. Rregullorja e Bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë</p>	<p>Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të</p>



<p>përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>ndryshuar, nenit 4 dhe nenit 7, Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, biblioteka në bashkëpunim me fakultetet dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje libri, materiale, pajisje, raftë, skanera, kompjutera, etj.</p> <p>Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore.</p> <p>Bazuar në këtë analizë vjetore, UAMD arrin të nxjerr në pah titujt që janë gjendje për program studimi, shfrytëzimin e titujve nga studentët si dhe efektin që ka dhënë pasurimi i fondit fizik.</p> <p><i>Evidenca 98. Bibloteka online</i> <i>Evidenca 102. Rregullorja e Bibliotekes</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ është e mendimit se shkalla e përmbushjes së këtij standardi është plotësisht. UAMD ka marrë masat e nevojshme që literatura të jetë e përditësuar për të gjitha programet e studimit, specifikisht për programin e studimit: Komunikim dhe Marketing Digjital.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="598 840 790 907">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="790 840 997 907">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="997 840 1252 907">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td align="center"><b>X</b></td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.

Në lidhje me ruajtjen e dokumentacionit mësimor , dhe aktivitetit të studentëve, Universiteti Aleksandër Moisiu, dhe Departamentit Menaxhim - Marketing, ka të ngritur një sistem menaxhimi të brendshëm. Sistemi funksionon në dy aspekte të administrimit të informacionit: informacioni ruhet në formë elektronike dhe në hardcopy.

Studenti regjistrohet në sekretarinë mësimore duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm si edhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MASR.

Pasi është regjistruar, studenti regjistrohet edhe në sistemin elektronik të sekretarisë ESSE3. Në këtë sistem studenti pajiset me kredenciale. Çdo student ka librezën e tij të studentit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me sistemin elektronik dhe 3 regjistrat e informacionit të studentit. Regjistri, themeltar, regjistri i notave dhe regjistri i diplomës. Ky i fundit menaxhohej nga krye sekretarja e fakultetit. Regjistrat ruhen, pas diplomimit, në arkivin e Shtetit Shqiptar, arkivin e UAMD-se si kopje e njësuar me origjinalin në formë hard-copy dhe elektronike. Kjo gjë vërehet te Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Këto të dhëna janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit. Sistemi PITAGORA ofrohet në bashkëpunim me

	<p>RASH. Për t'i ardhur në ndihmë studentëve në përdorimin e këtij sistemi, në faqen Ueb të UAMD<sup>1</sup> gjendet edhe një udhëzues përdorimi.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 82. Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD</i>  <i>Evidenca 103. Sistemi Pitagora RASH</i>  <i>Evidenca 12. Suplement diplome BA KMD</i>  <i>Evidenca. 11 Vërtetim Regjistrimi i Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Larte</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe takimeve me pedagogë dhe studentë, kjo platformë elektronike është tepër e rëndësishme për administrimin e brendshëm të dokumentacionit. Akresi për informacione të stafit akademik, ndihmës akademi dhe studentët zhvillohet duke respektuar kuadrin ligjor të të dhënave personale për pedagogë dhe student.</p> <p>Studentët shprehen të kënaqur për sistemin, I cili u jep në kohë rekord mundësinë për të menaxhuar ecurinë akademike.</p> <p>Këto të dhëna janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit të FB. Të dhënat janë të ruajtura për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e Fakultetit të Biznesit.</p> <p>Informacioni për mbarëvajtjen e procesit mësimor dokumentohet në stenda dhe web-in e Universitetit me seksion të veçanta për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit. Ky informacion lidhet me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, kurrikulën e programit, prioritet e kërkimit dhe fushat e ekspertizës, mundësitë e punësimit, kompetencat e stafit dhe studentëve etj.</p> <p><i>Evidenca 107. Print screen faqja IG Departamentit Marketing.</i>  <i>Evidenca 103. Sistemi Pitagora RASH.pdf</i>  <i>Evidenca 84. Orari me emra 2018-2022</i>  <i>Evidenca 13. Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion por edhe pas konsultimit me RVB është e qartë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj.</li> <li>- Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj.</li> <li>- Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</li> <li>- Financa ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të</li> </ul>

<sup>1</sup> <https://uamd.edu.al/pitagora/>

	<p>studimit dhe pagesave të kryera</p> <p><i>Evidenca 107. Print screen faqja IG Departamentit Marketing.</i></p> <p><i>Evidenca 103. Sistemi Pitagora RASH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 84. Orari me emra 2018-2022</i></p> <p><i>Evidenca 13. Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ konfirmon se të dhënat e përdoruesve janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që ata zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit të FB. Të dhënat janë të ruajtura për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FB. Çdo përdorues për sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FB/UAMD.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital.</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacioni për këtë program studimi është i aksesueshëm nëpërmjet faqes së WEB. Në faqen e institucionit ky program studimi ka një rubrikë të veçantë. Informacioni në faqen e ueb-it gjendet në 2 gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Faqja në gjuhën shqipe përmban informacionet e plota të të gjitha fushave, ndërsa faqja në gjuhën angleze përmban informacionet kryesore në lidhje me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme.</p> <p>Përtej faqeve zyrtare të institucionit, vetë Fakulteti i Biznesit ka faqen e tij në Facebook ku publikojnë çdo informacion, aktivitet apo thirrje specifike për programin e studimit</p> <p><a href="https://uamd.edu.al">https://uamd.edu.al</a>,</p> <p><i>Evidenca 107. Print screen faqja IG Departamentit Marketing.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konfirmon se UAMD disponon një sistem të brendshëm menaxhimi institucional, të cilin e vë në dispozicion të administrimit dhe informimit të monitorimit të aktivitetit akademik. Sistemi PITAGORA është plotësisht në mbështetje të gjithë aktivitetit akademik, administrativ dhe bën të mundur që informacioni të jetë pranë kujtdo përdoruesi në kohë rekord. Për tu vlerësuar maksimalisht menaxhimi i faqes në Facebook nga zv. Dekania e Fakultetit të Biznesit.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit është e përcaktuar që UAMD harton një raport financiar për mbështetjen financiare të nevojshme.</p> <p>Sikurse edhe na u relatua gjatë vizitës në institucion, ky raport hartohet nga Drejtoria Ekonomike, e cila ua vë në dispozicion departamenteve përgjegjëse për programin e studimit. Raportet financiare realizohen në rang njësie kryesore ose institucional duke diversifikuar shpërndarjen e kostove dhe të ardhurave midis programeve të studimit që ofron UAMD.</p> <p>UAMD për sa i takon financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p><i>Evidenca 108. Raport Financiar 2021-2022-UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Mbështetja e UAMD për programin e studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” është kryesisht për pagat e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, personelit ndihmës-akademik në shërbim të këtij programi studimi dhe për mirëmbajtjen e ambienteve në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Bizneset partnere dhe projektet kombëtare dhe ndërkombëtare mbështesin me investimet në pajisjet laboratorike, pagesat e trajnuesve të huaj (dieta, udhëtim, qëndrim), pagesat e konsulentëve të huaj dhe sponsorizime në aktivitete të ndryshme të organizuara në funksion të studentëve të Fakultetit të Biznesit.</p> <p>Institucioni harton edhe raportin e analizës financiare për të paktën tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si edhe nivelin e realizimit të shpenzimeve</p> <p><i>Evidenca 108. Raport Financiar 2021-2022-UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në RVB është relatuar se UAMD zhvillon auditime që i vijnë në ndihmë dokumentimit për gjendjen e financimit.</p> <p>Edhe gjatë takimeve na u bë me dije se UAMD analizon në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare.</p> <p>Tre janë burimet potenciale të financimit: Financim nga buxheti i shtetit, financim nga tarifat e studentëve si edhe financim nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë.</p> <p><i>Evidenca 108. Raport Financiar 2021-2022-UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ konfirmon se në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njëjësive kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.</p>

	<b>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p>Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës harton edhe raportin e analizës financiare për të paktën tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si edhe nivelin e realizimit të shpenzimeve.</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesin e departamentit dhe dekanin, na u konfirmua se ky dokument shërben për të identifikuar nevojat për financim dhe planifikuar, si rrjedhojë, ndërhyrjet e domosdoshme.</p> <p><b>Evidenca 1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</b> <b>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD i plotëson të gjitha kriteret për të ruajtur një qëndrueshmëri financiare në shërbim të programeve të studimit si dhe garanton përmbushjen e nevojave që mund të ketë ky program studimi, i cili në natyrën e tij është shumë specifike, ku kërkon shumë mjete profesionale dhe njerëz që janë më pranë profesionit të marketingut dhe digjitalizimit. GVJ është e mendimit se shkalla e përmbushjes së këtij standardi është plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
--	--	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka hartuar politika të qarta që mbulojnë të gjitha aspektet që duhen për këtë cikël studimi. Këto procedura fillojnë që nga kriteret e hyrjes së studentit, kalimi nga njëri vit në tjetrin, transferimet në hyrje dhe në dalje si dhe diplomimin në përfundim të studimeve. Konstatohet se kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MASR. Politikat e UAMD janë të bazuara në Statutin e Universitetit, në rregulloren e studimeve universitare të UAMD, Fakultetit të Biznesit, të programit të studimit të programit “Komunikim dhe Digjital Marketing”.



	<p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve në UAMD, përgjegjës është Komisioni i Vlerësimit. Lista përfundimtare shpallet sipas udhëzimeve të dala nga ministria përkatëse.</p> <p>Për transparencë i gjithë ky proces aplikohet në sistemin U-Albania ku çdo aplikant mund të informohet për rezultatin dhe ecurinë e aplikimit të tyre. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UAMD duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 129. Model Dosje Studenti</i>  <i>Evidenca 138. Rregullore për Studentët me Afësi të kufizuar</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në RVJ por edhe në dokumentacionin e dorëzuar konstatohet se, Çdo fillim viti akademik, Departamenti I Menaxhim marketingut propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital. Këto kritere pranimi miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet që bën departamenti dhe fakultetit</p> <p>Gjatë takimit me përgjegjësën e njësisë bazë u bëmë me dije se departamenti ndjek politika sipas Rregullores së UAMD dhe Fakultetit të Biznesit për shoqërimin e studentëve deri në diplomim. Këto politika u bëhen me dije studentëve që në hyrje të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL ne e konstatuam këtë procedure.  <i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 129. Model Dosje Studenti</i>  <i>Evidenca 119. Tabelën me Kuotat e miratuara për programet e Ciklit te pare dhe ciklit te dyte te studimeve,</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në RVB-në e përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, referohet se Institucioni harton dhe bën publike para çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe referon për këtë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Fakultetit.</p> <p>Informacioni është i aksesueshëm nga të gjithë në faqen zyrtare të UAMD. Në këtë faqe ka informacion të bollshëm për programet e studimit që ofrohen. Të interesuarit e marrin informacionin edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore. Senati Akademik i UAMD-së përfundon propozimin e tij për kuotat e pranimi në secilin fakultet, dhe I bën publike së bashku me informacionin e nevojshëm për fakultetin përkatës dhe programet që ofron. Përsa i përket procedurave të transferimit të krediteve, ato janë të përcaktuara qartë në rregulloret e institucionit.</p> <p><i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenca 112. Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit</i>  <i>Evidenca 111. Publikimi i Krihereve e Pranimi 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo</p>	<p>GVJ konfirmon se Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës ofron mundësi</p>



<p>viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë studentët që transferojnë studimet e tyre brenda të njëjtit cikël studimi, brenda UAMD por edhe në institucione të tjera</p> <p>Transferimet zhvillohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Në rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor "Komunikim dhe Digjital Marketing", propozohen kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të cilat miratohen në dekanat dhe shpallen në ueb-in e Universitetit / Fakultetit sipas programit të studimit.</p> <p>Përveç publikimeve në faqen elektronike zyrtare të UAMD dhe në rrjete sociale, këto kritere janë të publikuara edhe në portalin U-Albania ku çdo maturant mund ta aksesojë lehtësisht.</p> <p><i>Evidenca 112. Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit</i> <i>Evidenca 111. Publikimi i Krieteve e Pranimi 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me drejtuesin e njësisë bazë dhe dekanin, por edhe duke u konsultuar me dokumentacionin, GVJ konstaton se për çdo vit akademik, për kuotat e programit Bachelor në Komunikim dhe Digjital Marketing parashikohen kuota të synuara për kandidatë të kategorive të veçanta si dhe kandidatët e trojeve dhe shtetasit e huaj. Në lidhje me këtë program studimi ne konstatojmë se UAMD ka të programuara edhe politikat mbështetëse për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>Evidenca 112. Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit</i> <i>Evidenca 111. Publikimi i Krieteve e Pranimi 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konfirmon se UAMD harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera, mbi bazën e propozimeve të departamenteve. Deri tani departamenti nga ku buron ku program studimi ka të parashikuar në kuotat e tij vetëm për kandidatë shqipfolës.</p> <p>Këto kritere përcaktojnë notën mesatare, formimin e aplikantit etj, nëpërmjet kuotave të miratuara dhe përcaktuara nga MASR.</p> <p><i>Evidenca 112. Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit</i> <i>Evidenca 111. Publikimi i Krieteve e Pranimi 2022-2023</i> <i>Evidenca 119. Tabelën me Kuotat e miratuara për programet e Ciklit te pare dhe ciklit te dyte te studimeve, për vitin akademik 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konfirmon se UAMD harton politika të ndihmës/bursave për shresat në nevojë, duke u bazuar në vendimin e Bordit të Administrimit.</p> <p>Gjithashtu konfirmohet se UAMD zbaton politika mbështetëse për individët me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke përjashtuar tarifatat e studimit, dhënies së bursave sipas kategorive të caktuara dhe aktiviteteve të ndryshme sociale. Duke i ardhur kështu në ndihmë këtyre kategorive.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Evidenca 119. Tabelën me Kuotat e miratuara për programet e Ciklit te pare dhe ciklit te dyte te studimeve, për vitin akademik 2021-2022</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Është mëse e qartë se UAMD ka hartuar politika të qarta që mbulojnë të</i></p>



	<i>gjitha aspektet që duhen për këtë cikël studimi, përfshi këtu kriteret hyrëse, kriteret e bursave dhe kriteret për informim të të gjithë të interesuarve. GVJ konfirmon se institucioni e përmbush plotësisht këtë standard.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në RVB, por edhe nga takimet në institucion konstatohet se sekretaria mësimore dhe sistemi PITAGORA luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentit për përparimin e tij akademik.</p> <p>Një rol të rëndësishëm për këtë kriter luan dhe Koordinatori programit të studimit. Koordinatorja e programit Bachelor në Komunikim dhe Digjital Marketing si dhe drejtuesit e Fakultetit të Biznesit organizojnë takime periodike me studentët e këtij programi për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për t'i informuar për çdo kërkesë dhe afat që ndikon në përparimin e tyre akademik.</p> <p>Procedurat e përparimit të studentit si dhe të kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD. Vendimet janë të publikuara në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p><i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurave të njohjeve të krediteve nga studime të mëparshme. Ata janë të pasqyruar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit .</p> <p>Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se metoda e vlerësimit me notë dhe pikë janë publike dhe të qarta në syllabus. Edhe nga takimi me studentët na u bë me dije se pedagogët që në orën e parë të mësimit për çdo lëndë bëjnë të qarta procedurat e vlerësimit të dijeve për çdo lëndë.</p> <p>Informacioni për çdo proces mësimor publikohet përmes njoftimeve në stendat e Fakultetit të Biznesit, në format digjital përmes faqes së Fakultetit dhe Departamentit në rrjetet sociale, si orari i mësimit, njoftime apo rezultate të veprimtarive të ndryshme, etj.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p><i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD, rregulloren e fakultetit, rregulloren e njësisë bazë dhe rregulloren e programit të studimit Komunikim dhe Digjital Marketing. Gjithashtu nga takimi me pedagogët por edhe me studentët na u konfirmua edhe njëherë se detyrimet përmbyllëse për studentët e ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Biznesit zhvillohen në dy forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kur studenti ka një mesatare mbi notën 7, i shlyen detyrimet përmbyllëse me hartimin e temës dhe mbrojtjen e diplomës përpara një komisioni të posaçëm.</li> <li>- Kur studenti ka një mesatare nën notën 7, ai i shlyen detyrimet përmbyllëse duke zhvilluar provimin përmbyllës.</li> </ul> <p><i>Evidenca 79. Rregullore Diplomimi Vendim Senat</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenca 94. Tabela e Shpërndarjeve të Temave Bachelor</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UAMD në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambientet universitare të FB,</li> <li>- Takime informuese në gjimnaze për maturantët</li> <li>- Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale.</li> </ul> <p>Takime informuese online me grupe maturantësh në rang gjimnazesh.</p> <p><i>Evidenca 15. Promovim tek maturantet</i>  <i>Evidenca 116. Promovimi i KMD në faqen e Departamenti</i>  <i>Evidenca 117. Promovimi në Rrethet -Broshura Promovimi i Programeve</i>  <i>Evidenca 114. Promovimi në faqen e departamentit.</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Studentët informohen që në hyrje për mënyrën e vlerësimit dhe udhëzohen nga njësitë përgjegjësi për kontrollin e njohurive të dijeve si dhe për mënyrën e punimit të diplomës.</i>  <i>GVJ konfirmon se UAMD e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht			X
Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht					
		X					

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e marrin informacionin për strukturën dhe kohëzgjatjen e studimeve nga faqja zyrtare e UAMD por gjithashtu edhe nëpërmjet koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Çdo student në momentin e regjistrimit në programin e studimit “Komunikim dhe Digjital Marketing” merr nga sekretaria mësimore kurrikulën e programit të studimit ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve,</p>



	<p>kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje).</p> <p>Gjithashtu Informacioni i përgjithshëm mbi politikat dhe procedurat mund të aksesohet në rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimeve bachelor “Komunikim dhe Digjital Marketing”.</p> <p><i>Evidenca 122. Foto Java e Orientimit Viti 1</i>  <i>Evidenca 121. Orientimi studenteve Vendimi i rektoratit Nr. 10, dt 06.09.2019</i>  <i>Evidenca 120. Informimi Studenteve - Shembull Orari Mesimor</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në fillim të çdo lënde studentët marrin nga personeli akademik i kursit programin e lëndës ku përcaktohen qartë temat dhe shpërndarja e tyre përgjatë semestrit, periudha e provimeve, objektivat formues, mënyra e vlerësimit etj. Kjo gjë është pasqyruar në RVB por nga u konfirmua edhe përgjatë takimeve me pedagogët e këtij program studimi dhe përgjatë takimeve me studentët e po këtij programi.</p> <p><i>Evidenca 25. Objektivat e Programit të studimit bsc KMD</i>  <i>Evidenca 69. Asistimet dhe datat e provimeve Bachelor</i>  <i>Evidenca 120. Informimi Studenteve - Shembull Orari Mesimor.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga GVB dhe nga drejtuesi i njësisë bazë u informuam se, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve studentët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e biznesit. Në UAMD është e ngritur Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumnit për të koordinuar të gjithë punën në aspektin e vlerësimit të mundësive të punësimit dhe suportit institucional të studentëve. Në kuadër të ofrimit të mundësive për përfshirjen e studentëve në tregun e punës, ka të ngritur Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës. Kjo zyrë zhvillon aktivitete për studentët të cilat kanë si qëllim njohjen dhe përafrimin e tyre me tregun e punës, përgatitjen e tyre për t'u bërë pjesë e këtij tregu. Nga pedagogët por edhe drejtuesit e njësive të Fakultetit na u bë me dije se: Fakulteti Biznesit organizon për të tretin vit radhazi, me pjesëmarrjen e mbi 150 subjekteve Panairin e Punës dhe Karrierës, e cila është një mundësi shumë e mirë zhvillimi dhe integrimi për punësimin e studentëve, pas dhe gjatë kohës së tyre të studimit.</p> <p><i>Evidenca 125. Trajnime për studentët nga Kompani private</i>  <i>Evidenca 124. Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës</i>  <i>Evidenca 123. Panairi i Punës Fakulteti i Biznesit</i>  <i>Evidenca 90. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenca 93. Draft Agjendë panairi i punës dhe i karrierës 2022</i>  <i>Evidenca 92. Foto Panairi i Punës Fakulteti i Biznesit</i>  <i>Evidenca 134. Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në javën e parë të mësimit që është edhe java e orientimit për studentët e vitit të parë, studentët informohen edhe për ambientet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Biznesit që është në dispozicion të studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.</p> <p>Kurse sistemi Pitagora, është i aksesueshëm për studentët në mënyrë që ata të njihen me sallat, orari, vlerësimi për lëndë, etj. Të gjitha aktivitetet janë të përqendruara në sistemin Pitagora, ku çdo anëtar pjesëtar i UAMD sipas rolit, mund të marrë informacionin e dëshiruar.</p>

	<p><i>Evidenca 116. Promovimi i KMD ne faqen e Departamenti</i>  <i>Evidenca 120. Informimi Studenteve - Shembull Orari Mesimor</i>  <i>Evidenca 122. Foto Java e Orientimit Viti I</i>  <i>Evidenca 121. Orientimi studenteve Vendimi i rektoratit Nr. 10, dt 06.09.2019</i>  <i>Evidenca 134. Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ konstaton se informacioni gjendet lehtësisht në faqen e UAMD, por edhe në sistemin Pitagora, si rrjedhojë, ky informacion është i aksesueshëm edhe në distancë.</p> <p>Informacioni në lidhje me programin e studimit u ofrohet studentëve personalisht me komunikim të drejtpërdrejtë nga sekretaria mësimore.</p> <p><i>Evidenca 116. Promovimi i KMD ne faqen e Departamenti</i>  <i>Evidenca 120. Informimi Studenteve - Shembull Orari Mesimor</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për t'u vlerësuar shpërndarja e informacionit nëpërmjet sistemit Pitagora dhe faqes zyrtare Fakultetit të Biznesit. Çdokush mund të gjejë informacionin e dëshiruar në këto dy opsione të ofruara nga institucioni. GVJ konfirmon se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UAMD mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Në sekretarinë mësimore ruhet dokumentacioni i procesit mësimor. Nga punonjësit e Zyrës së Këshillimit të karrierës dhe Alumnit u vumë në dijeni se kjo zyrë mban statistika të plota në lidhje me numrin e të diplomuarve në programin e studimit “Komunikim dhe Digjital Marketing” Gjithashtu u bëmë me dije se kjo zyrë asiston në gjurmimin e studentëve që përditësohet çdo vit. Departamenti i Marketingut përgatit çdo vit analizën mësimore në të cilën janë të pasqyruara statistikat vjetore në lidhje me numrin e të diplomuarve në programin e bachelorit Komunikim dhe Digjital Marketing. Ky informacion ruhet në departament së bashku me shumë të dhëna të tjera në lidhje me studentët</p> <p><i>Evidenca 126. RVB_FB 2020-2021</i>  <i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i>  <i>Evidenca 134. Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion por bazuar edhe në RVJ u konstatua se Sekretaria mësimore mban dosjen personale të studentit, e cila krijohet nga momenti i regjistrimit dhe përditësohet gjatë gjithë jetës së tij studentore. Gjatë vizitës u kërkuan 2 dosje të dy studentëve, një e këtij viti akademik dhe një të një studentit të vitit të tretë. Në këtë dosje gjenden edhe informacione mbi</p>



	<p>praktikën dhe punimin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i>  <i>Evidenca 18. Raport Vjetor UAMD 2020-2021</i>  <i>Evidenca 129. Model Dosje Studenti</i>  <i>Evidenca 134. Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konfirmon se Departamenti në çdo kohë mund të analizojë të dhënat e studentëve nëpërmjet regjistrave fizikë që mban nga sekretaria mësimore, si edhe të analizoje të dhënat e gjeneruara në databasen e të dhënave për studentët e regjistruar në këtë program (dokumenti database të regjistruar në Bsc Komunikim dhe Digjital Marketing me të gjitha të dhënat e detajuara). Informacioni ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërmdahet vetëm tek palët e autorizuar sipas ligjeve dhe akteve nënligjore për Arsimin e Lartë dhe Rregulloreve të UAMD.</p> <p><i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i>  <i>Evidenca 18. Raport Vjetor UAMD 2020-2021</i>  <i>Evidenca 129. Model Dosje Studenti</i>  <i>Evidenca 14. Organigrama UAMD</i>  <i>Evidenca 32. Organigrama FB</i>  <i>Evidenca 31. Organigrama Departamenti i Marketingut 2022</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Nëpërmjet takimeve që zhvilluam me drejtuesin e njësisë dhe grupin e vlerësimit të brendshëm konstatohet se është Rektorati dhe drejtoritë përkatëse që kryejnë kontrole periodike pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve. Këto kontrole lidhen me menaxhimin e informacioneve të dhe dokumentacioneve, si dhe me vlerësimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit të ruajtur në këto zyra. Këto kontrole mund të organizohen në nivel njësie kryesore, në nivel institucional dhe në disa raste si audit i jashtëm nga MAS.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësitë kryesore dhe njësitë bazë të Universitetit "Aleksandër Moisiu" hartojnë raporte të përvitshme në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Këto raporte bëhen pjesë të RVB-së në UAMD. Gjatë vizitës së GVJ në IAL drejtuesi i njësisë bazë na sqaroi për këtë procedurë. Raportet analitike ishin shumë të domosdoshme për të përmirësuar programin e studimit. Njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi e kryen këtë raport analitik në funksion të mbarëvajtjes të veprimtarive të gjithë njësisë në tërësi, përfshi këtu veprimtari mësimore dhe shkencore.</p> <p><i>Evidenca 126. RVB_FB 2020-2021</i>  <i>Evidenca 25. Objektivat e Programit të studimit bsc KMD</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konfirmon se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard në lidhje me cilësinë në hyrje dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi. Njësia bazë është në punë të vazhdueshme që të dhënat e grumbulluara të jenë në shërbim të përmirësimit të programit, në mënyrë që ky i fundit të ishte sa më pranë tregut të punës.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, me anëtarët e GVJ-së por edhe nga vetë RVJ na u bë me dije se, studentët kanë përfaqësuesit e tyre në çdo organ vendimmarrës në UAMD në raporte sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatën Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si NJBSC, Këshillin e Etikës etj. Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit, realizohet referuar ligjit për arsimin e lartë dhe në zbatim të plotë të tij, Statutit të UAMD dhe Rregullores së UAMD.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni i përfshin studentët si përfaqësues, në organet vendimmarrëse të UAMD. Kjo gjë na u konfirmua edhe në takimin me studentët, por edhe në takimin me Zyrën e Këshillimit dhe karrierës. Gjithashtu gjatë takimit me studentët u diskutua edhe për Këshillin studentor dhe aktivitetet e tij. Procedurat për përzgjedhjen e Studentëve në Organet vendimmarrëse janë transparente dhe sigurojnë barazi në pjesëmarrjen në këto procese. Duke filluar që nga propozimet e emrave të kandidatëve përfaqësues të studentëve në Organet vendimmarrëse deri te përzgjedhja e tyre, përmes votimit dhe publikimit të rezultateve, procesi është shumë transparent.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Sipas GVJ studentët komunikojnë me koordinatoren e programit të studimit për të gjitha problematikat që kanë gjatë gjithë jetës studentore. Gjithashtu koordinatori na konfirmoi se është pikërisht ai dhe drejtuesi I njësisë bazë që kujdesen për të marrë sugjerimet e studentëve për përmirësimin apo rishikimin e programit mësimor dhe shërben si pikë kontakti midis tyre dhe njësisë. Gjithashtu studentët na konfirmuan se mbajnë kontakte të rregullta me të gjithë pedagogët, sidomos me përgjegjësin e departamentit. Përgjegjësi I departamentit na konfirmoi se, duke qenë se ky program studimi ka në numër të vogël studentësh, afërsisht 15 studentë në vit akademik, nuk është aspak e vështirë komunikimi me ta.</p> <p>Studentët na konfirmuan edhe njëherë gjatë takimit se në javën e 13-të dhe të 14 të semestrit zhvillojnë plotësimin e pyetësorit për vlerësimin e performancës së stafit akademik në mësimdhënie.</p> <p>Pyetësori propozohet nga KPGSC (Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë) dhe miratohet nga Senati Akademik. Rezultatet e nxjerra nga ky pyetësor, reflektohen në an RVB –në e Fakultetit të</p>

	<p>Biznesit.</p> <p><i>Evidenca 66. Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët - final CleanScore Maj 2018</i></p> <p><i>Evidenca 59. Pyetsor për studentët e Bachelor në "Komunikim dhe Marketing Digjital</i></p> <p><i>Evidenca 71. Model Pyetesori stafi akademik</i></p> <p><i>Evidenca 67. Pyetsor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga RVB dhe nga takimi me studentët GVJ konstaton se studenti, në rast se është i pakënaqur me rezultatin për një vlerësim të caktuar paraqet kërkesën e tij tek drejtuesi i njësisë bazë. Ky i fundit kërkon ngritjen e një komisioni rivlerësimi. Komisioni i rivlerësimit merr vendim pas rishqyrtimit. GVB na konfirmoi se vendimi i këtij komisioni është i formës së prerë dhe nuk kthehet më. Ky vendim përcillet në sekretari, e cila bën dhe njoftimin për studentin. Personeli akademik ka detyrim të ballafaqojë rezultatet me studentët 72 orë nga realizimi i testimit dhe të sqarojë çdo paqartësi të tyre në lidhje me vlerësimin e testimit.</p> <p><i>Evidenca 68. Rregullore provimeve Fakulteti Biznesit</i></p> <p><i>Evidenca 69. Asistimet dhe datat e provimeve Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca 80. Shembull -Komunikim me e-mail me Studentet.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Këshilli studentor është funksional dhe aktiviteti i tij është I prekshëm. Studentët e njohin përfaqësuesit e tyre senator të këshillit studentor. Njësia bazë dhe Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumni luan një rol të rëndësishëm në jetën studentore duke ofruar mbështetjen e saj të plotë për mbarëvajtjen e saj.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka njësi të posaçme të informimit në shërbim të studentëve: Njësia përgjegjëse për informimin e studentëve në UAMD është Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë. Gjatë takimit me studentët, GVJ i pyeti nëse e njihnin këtë zyrë dhe pse paraqiteshin tek aty. Studentët e të trija viteve u shprehën se mbanin</p>



	<p>kontakte të rregullta me këtë zyrë për të gjitha aktivitetet studentore.</p> <p><i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Komunikimi i studentëve me pedagogët është shumë transparent. Studentët u shprehën tepër të kënaqur nga ndihma e pedagogëve në çdo kohë. Vënia në dispozicion i emaileve të pedagogëve mentorues përmes të cilëve studentët krijojnë një komunikim të vazhdueshëm për procesin mësimor, pasi përmes komunikimit me profesorët mund të informohen për materiale me karakter didaktik dhe kërkimor, Cikle leksionesh, konspekte, artikuj, studime.</p> <p>GVJ pasi u këshillua me dokumentacionin dhe nga takimet me përfaqësues të zyrës së këshillimit dhe alumnit, vuri re se kjo zyrë është gjithnjë aktive dhe pranë studentëve. Në takimin me studentët, u theksua se njësi bazë jep një ndihmë shumë të madhe në asistimin e studentëve për problematika të ndryshme që mund të hasin gjatë vitit akademik. Që ditën e parë në regjistrim, studentët asistohen nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit dhe njësi bazë, në të cilën kryejnë studimet.</p> <p><i>Evidenca 137. Udhëzuesi i Karrierës</i>  <i>Evidenca 120. Informimi Studenteve - Shembull Orari Mesimor</i>  <i>Evidenca 69. Asistimet dhe datat e provimeve Bachelor</i>  <i>Evidenca 80. Shembull -Komunikim me e-mail me Studentet.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit, trajnimet dhe kontaktet me studentët e diplomuar realizohen direkt nga njësi bazë dhe Fakulteti, ku një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i ngushtë me bizneset. Personeli akademik i Fakultetit dhe njësitë bazë raportojnë te drejtuesit e Fakultetit në lidhje me organizimin e aktiviteteve informuese dhe merr miratimin e tyre për realizimin e këtyre aktiviteteve. Përsa i përket programit bachelor në Komunikim dhe marketing digjital, informimi nuk mbetet vetëm tek Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, por një pjesë të rëndësishme lunate dhe vetë njësi bazë. Studentët u shprehën se nuk u mungon asnjëherë mbështetja e pedagogëve të departamentit për ndihma që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca 137. Udhëzuesi i Karrierës</i>  <i>Evidenca 120. Informimi Studenteve - Shembull Orari Mesimor</i>  <i>Evidenca 80. Shembull -Komunikim me e-mail me Studentet.</i>  <i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sipas takimit në institucion, Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI ka krijuar një database të të dhënave dhe gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhënat çdo vit.</p> <p>Sipas anëtarëve të kësaj njësie gjurmimi i studentëve ndihmon departamentet që të kuptojnë se ku janë punësuar studentët e programeve të studimit që ata ofrojnë.</p> <p>Zyra e Këshillimit të karrierës dhe Alumni ka mundur disa bashkëpunime efektive me Kompani të ndryshme, veçanërisht me kompani telefonike, kompani që veprojnë në fushën e teknologjisë së informacionit, të statistikës dhe kontabilitetit etj.,</p> <p><a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a> ALUMNI</p>



	<i>Evidenca 89. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës</i> <i>Evidenca 137. Udhëzuesi i Karrierës</i>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ është e mendimit se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard, pasi përgjatë takimeve me grupet e ndryshme sipas agjendës së takimeve, vihet re një përpjekje e vazhdueshme që bën drejtoria e komunikimit dhe njësia bazë, në mënyrë që studenti i UAMD të jetë gjithnjë pranë tregut të punës.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në RVJ dhe dokumentacionet e dorëzuara në RVB u bëmë me dije se UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. Kjo njësi organizon gjatë vitit akademik trajnime për personelin akademik në lidhje me metodat inovative në mësimdhënie si dhe për rritjen e aftësive pedagogjike të personelit akademik. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës i kushton vëmendje metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Këto metoda janë të parashikuara në Rregulloren për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.  <i>Evidenca 1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu"</i> <i>Evidenca 63. Miratimi i Ndryshimeve të Rregullores së Cilësisë së Evidenca Brendshme UAMD</i> <i>Evidenca 62. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Fakulteti i Biznesit, më specifiku departamenti i këtij fakulteti merr masa që të monitorojë aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik.  Instrumentet që përdor monitorohen në mënyrë periodike nga UAMD. Monitorimi dhe vlerësimi i tyre maten me anë të këtyre instrumenteve:  1. Analiza e kalendarit të aktiviteteve të departamentit gjatë mbledhjeve të njësisë bazë. 2. Pyetësi i studentëve, ku në fund të semestrit studentët japin

	<p>vlerësimin e tyre për stafin akademik.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>3. Formulari i vlerësimit të performancës së pedagogut</li> <li>4. Pyetësor online i Fakultetit drejtuar studentëve, nga ku merret mendim i studentëve për stafin akademik dhe administrativ.</li> </ol> <p><i>Evidenca 71. Model Pyetesori stafi akademik.pdf.pdf</i>  <i>Evidenca 130. Formular i vevlerësimit te performancës së personelit akademik</i>  <i>Evidenca 67. Pyetsor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Evidenca 66. Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët - final CleanScore Maj 2018</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik realizohet bazuar në anketimet periodike të studentëve çdo fund semestri mësimor.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatohet se strukturat përgjegjëse NJSBC dhe KSBC organizojnë vetëm vlerësimet peridodike të pyetësorëve në rang institucional. Edhe pse ky monitorim bëhet në rang institucional, Fakulteti i Biznesit e ka të përcaktuar e dhe në Rregulloren e Provimeve mënyrën e administrimit dhe transparencës në vlerësimin e dijeve ku studentët përfshihen në trajtimin e ankimimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Gjatë takimit me studentët, këta të fundit na pohuan se pyetësorët zhvillohen në dy semestra.</p> <p><i>Evidenca 67. Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Evidenca 66. Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët - final CleanScore Maj 2018</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 131. Raporti Pedagogut nga Pyetësori Studenteve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Për sa i përket Departamentit të Marketingut si Njësi Bazë, bazuar edhe nga takimet në institucion, GVJ është e mendimit se kjo njësi promovon shembuj të praktikave të mira duke organizuar orë leksionesh të hapura me studentët e ciklit të parë dhe duke ftuar të gjithë anëtarët e departamentit. Studentët dhe pedagogët na pohuan gjatë takimeve se, këto orë janë tepër të vlefshme për të dyja palët dhe se realizohen me specialistë të njohur dhe të suksesshëm ndërkombëtarë dhe kombëtarë. Gjithashtu edhe mobilitetet e stafit dhe studentëve ndikojnë në promovimin e praktikave të mira për këtë njësi bazë.</p> <p><i>Evidenca 21. Lista e Mobiliteteve te Stafit &amp; Studenteve &amp; Mobility Agreement</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ është e mendimit se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard. Megjithatë gjatë takimit me drejtuesit e NJSBC, njësisë kryesore dhe njësisë</p>

	bazë, GVJ la sygjërimin që të tërhiqet mendimi i studentëve edhe për lëndën dhe jo vetëm për pedagogun.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në zbatim të nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohet se njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë.</p> <p>Misioni i kësaj Drejtorie / NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim.</p> <p><i>Evidenca 62. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Referuar Rregullores se UAMD, NjBSC kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel institucional në nivel insitucional.</p> <p>NjBSC e FB kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti kur kjo kërkohet nga drejtuesit e FB ose nga rregulloret institucionale. NjBSC monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, vetëm nga pyetësorët e studentëve për vlerësimin e pedagogëve.</p> <p>Ekspertët e jashtëm janë përfshirë si bashkëpunëtorë nga vlerësimet e akreditimeve të programeve të ndryshme. Për të siguruar një informacion sa më të saktë mbi studentët dhe kërkesat e tyre, si dhe për të marrë vendime në interes të tyre NjBSC dhe KPSC kanë në përbërje edhe një student.</p> <p>Sa sipër konfirmohet nga studentët dhe pedagogët gjatë takimeve në institucion.</p> <p><i>Evidenca 62. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Në rregulloren e NjBSC gjenden të shprehura afatet dhe procedurat e akreditimit. Nga dokumentacioni konstatohet se UAMD i është nënshtruar 2 herë akreditimit institucional dhe në të dyja akreditimet është vlerësuar me 4 vite.</p> <p>Më specifikisht:  2016- 4 vite  2021- 4 vite..</p>



	<i>Evidenca 62. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>Evidenca 133. Raporti-i-Vetëvlerësimit 2019-2020 NJSBC</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	Është e qartë se si pjesë e raportit vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë është edhe monitorimi i mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit shkencor. Në takimin me drejtuesin e NJSBC GVJ sygjeroi që njësia të ketë një plan pune me të qartë në lidhje me mbarëvajtjen e aktivitetit mësimor dhe në bashkëpunim me njësinë bazë të procedojnë me monitorime që i shërbejnë ruajtjes së standarteve dhe cilësisë. Monitorimet të kenë si qëllim përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, respektimin e formateve të programeve të lëndëve dhe shumë formateve që janë në shërbim të procesit mësimor.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Evidenca 62.Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>GVJ shprehet se standardi është i plotësuar plotësisht. Të dy njësive NJSBC dhe Departamentit iu sugjerua të mos mbeten në vlerësim vetëm tek pyetësori i studentëve në dy semestra. Të dy njësive iu sugjerua në takime që të shtohet në plan veprimet e tyre edhe monitorimi nga drejtuesit. Monitorimet nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe ajo bazë të zhvillohen kryesisht tek pedagogët me eksperiencë të re në mësimdhënie.</i>		
<b>Shikalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënjit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga GVJ por edhe nga takimi me drejtuesin e njësisë bazë na u konfirmua se çdo fillim viti akademik asambleja e personelit akademik të njësisë bazë diskuton në lidhje me programet e studimit që mbulon duke përfshirë edhe programin bachelor në Komunikim dhe Digjital Marketing. Në rastet kur shikohet e arsyeshme njësia bazë propozon / miraton ndryshimet e nevojshme duke dokumentuar formalisht ndryshimet e bëra dhe arsyetimet përkatëse.  Programet e studimit, si ato të reja, ashtu edhe për riorganizime, propozohen nga njësitë bazë dhe përcillen në Rektorat ku Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DSKC) vlerëson përmbushjen e standardeve ligjore dhe të cilësisë dhe më tej kalon për miratim edhe në organet e tjera kolegjiale siç është Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe së fundmi kalon për miratim në Senatin Akademik.  <i>Evidenca 18. Raport Vjetor UAMD 2020-2021</i> <i>Evidenca 126. RVB_FB 2020-2021</i> <i>Evidenca 133. Raporti-i-Vetëvlerësimit 2019-2020 NJSBC</i>
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e	Pas konsultimit me RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstanton se Vlerësimi i mbarëvajtjes së programit bachelor në Komunikim dhe Digjital Marketing bazohet në disa parametra sasior dhe cilësor të cilët vijnë vetëm nga statistikat e ofruara nga sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit dhe

<p>marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>anketimet e studentëve.</p> <p>Disa nga parametrat që përdoren për vlerësimin e programit të studimit janë cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit, opinioni i studentëve për lëndë të veçanta dhe për programin e studimit në përgjithësi etj.</p> <p>Procesi i vetëvlerësimit të stafit akademik në departament është një dokument i rëndësishëm për të parë ecurinë e stafit akademik në drejtim të kërkimit shkencor, mësimdhënies, angazhimeve në detyra administrative dhe komisione ad-hoc etj.</p> <p>Lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të dhe dosjet e tyre të vetëvlerësimit. Këto dosje qëndrojnë në departament dhe tek zyra e burimeve njerëzore si dhe vlerësohen nga drejtuesi i departamentit dhe dekani. Çdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik. Vlerësimi bëhet në bazë të formatit të vlerësimit i cili trajtohet nga koordinatori i kërkimit shkencor që është përzgjedhur me vendim departamenti.</p> <p><i>Evidenca 71. Model Pyetësori stafi akademik</i>  <i>Evidenca 133. Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në RVJ por edhe nga takimi me drejtuesin e NJSBC, Vlerësimi i cilësisë së programit bachelor Komunikim dhe Digjital Marketing sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- cilësisë dhe numrit të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie për këtë program</li> <li>- cilësisë së materialeve mësimore dhe plotësuese</li> <li>- infrastrukturës mësimore</li> <li>- ndërkombëtarizimit</li> </ul> <p>Pas konsultimit me dokumentacionin, gjatë takimit me drejtuesin e NJSBC, GVJ sygjeroi që këta elemente matës të bëhen sa më efektive dhe në shërbim të programit dhe institucionit në tërësi, për ruajtjen e standardeve dhe cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>  <i>Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë bën një sërë përpjekjesh në mënyrë që të aplikohet si duhet instrumenti i vlerësimit të mësimdhënies për pedagogët si dhe vlerësimi i institucionit nga stafi administrativ, nga stafi akademik dhe studentët. Në UAMD një vend të rëndësishëm zënë dhe sondazhet që zhvillohen rregullisht mbi punësimin e ish - studentëve alumni. Këto sondazhe kryhen nga Zyra e Karrierës janë një bazë të dhënash me shumë vlerë për të parë ndikimet e arsimimit tek studentët dhe oportunitetet e tregut të punës. Sondazhet ndiqen me rigorozitet nga vetë njësia bazë.</p> <p><i>Evidenca 67. Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Evidenca 134. Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet.</i></p>



në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.							
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht. Njësia bazë është gjithnjë në përpjekje për të rritur metodat që rrisin qëndrueshmërinë dhe cilësinë e programit të studimit. Duket se kjo njësi bazë është shumë pranë tregut të punës duke i dhënë rëndësi të veçantë cilësisë së programit të studimit.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se në lidhje me këtë program studimi, njësia bazë e ka të rëndësishëm angazhimin e studentëve dhe partnerëve të tregut të punës. Studentët ndihen të përfaqësuar në të gjitha organet kolegjiale. Këtë gjë e vërtetojmë edhe në takimet me vetë studentët dhe pedagogët. Studentët i njihnin të gjitha njësitë e tjera përveç njësisë bazë dhe na konfirmuan pjesëmarrjen e tyre me përfaqësues të të gjitha njësitë. Si studentët ashtu edhe partnerët e tregut të punës kanë një rëndësi të madhe me praninë e tyre gjatë vendimmarrjeve të njësisë bazë në lidhje me programin e studimit. <i>Evidenca 135. Sugjerim nga një biznes për riorganizimin e programit Bsc KMD. Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Universitetit, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive dhe individëve në lidhje me sigurimin e cilësisë janë të shprehura. Gjatë takimit me drejtuesin e NJSBC, GVJ u përmendi detyrat e NJSBC (Funkcionet dhe kompetencat e NJSBC. NJSBC monitoron duke ofruar udhëzime, duke mbledhur informacione dhe duke evidentuar probleme të cilat i përcjell në njësitë përgjegjëse për zgjidhje). Institucioni ka të mirë përcaktuara rolet dhe detyrat për stafin akademik, administrative, studentët, stafit ndihmës-akademik dhe ndihmës-administrativ. <i>Evidenca 62. Rregullore për sigurimin e cilësisë. Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga takimi me pedagogët por edhe me përfaqësues të NJSBC na u konfirmua se për sigurimin e cilësisë në këtë program studimi, vend të rëndësishëm zë edhe NJSBC e fakultetit. Ky i fundit ka në përbërje nga një anëtar për njësi bazë. Për sa i përket stafit administrativ dhe ndihmës akademik, edhe ata janë të angazhuar me vlerësimin e standardeve dhe japin kontributin e tyre. Duket se njësia bazë por edhe ajo kryesore ka gjithnjë në vëmendje përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe ruajtjen e standardeve që e bëjnë këtë program studimi cilësor.



	<i>Evidenca 62. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë. Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Garantimin e integritetit akademik si dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazisë e dëshmojnë edhe Rregullorja, për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë por edhe Kodi i Etikës në përdorim.  Stafi administrativ dhe si akademik respekton integritetin akademik dhe kujdeset për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.  <i>Evidenca 62. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë. Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit. Evidenca 2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës Evidenca 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ që në takimin e parë me drejtuesin e njësisë bazë dhe drejtuesin e njësisë kryesore u njoh me marrëdhëniet e ngushta që mbante njësia me bashkëpunëtorët e jashtëm. Drejtuesi I njësisë bazë na konfirmoi se programi i studimit "Komunikim dhe Marketing Digjital është hartuar mbi bazën e mendimeve, sugjerimeve dhe ekspertizës së specialistëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Hartimi i kurrikulave bashkëkohore dhe syllabuseve të programit të studimit është bërë nga lektorët e njësisë bazë të ku një pjesë e tyre kanë studiuar dhe kanë ekspertizë në universitete të huaja.  <i>Evidenca 7. Rregullore e Bachelor në Komunikim dhe Marketing Digjital Evidenca 17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Standarti përmbushet plotësisht. GVJ vlerëson faktin se institucioni i ka të ngritura të gjitha politikat e cilësisë tek njësitë. Gjithashtu GVJ vlerëson punën e njësisë bazë dhe njësisë kryesore për të siguruar standardet e cilësisë në këtë program studimi.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Referuar RVJ por edhe bazuar në faqen zyrtare të UAMD, Institucioni ka ndërtuar rregullore të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë të institucionit duke përfshirë dhe analizat mbi programin e studimit. Institucioni funksionon sipas Statutit, Rregullores dhe bazës përkatëse ligjore në vend. Këtë gjë e konfirmuam edhe me dekanin dhe zv.dekanen e Fakultetit të Biznesit përgjatë takimit në institucion. Në faqen W  eb të institucionit uamd.edu.al, në rrjetet sociale të institucionit si dhe në faqen e facebook-ut për Fakultetin e Biznesit janë pasqyruar të gjitha informacionet e nevojshme për veprimtarinë.  <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programi-i-transparences/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programi-i-transparences/</a>

	<p><a href="https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/">https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/">https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UAMD sipas rregullores dhe kodit të etikës publikon rezultatet dhe analizat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit duke respektuar etikën akademike dhe privatësinë e palëve të përfshira. Rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve gjenden edhe në faqen zyrtare të UAMD</p> <p>Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës.</p> <p><i>Evidenca 62. Rregullore per Sigurimin e Cilesise.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në RVJ: Në rastet kur evidentohen rezultate nën nivelin mesatar për lektorët me kohë të pjesshme, në vitin akademik pasardhës kontrata e tij nuk rinovohet. Në rastet kur evidentohen rezultate jo të kënaqshme për lektorët me kohë të plotë, Drejtuesit të NJSBC-së i lind e drejta për të dhënë vërejtje.</p> <p>Sa sipër përgjatë takimin me drejtuesin e NJSBC, GVJ sugjeroi që në planin e punës së NJSBC të planifikohen edhe trajnime që kanë të bëjnë me detyrimet që ka një pedagog dhe funksionet e njëjsteve të tjera të UAMD, në mënyrë që pedagogu të ndihmohet që në hyrje për të kuptuar se cilat janë standardet në UAMD dhe të punojë që në fillim për t'i zhvilluar dhe përmirësuar ato.</p> <p><i>Evidenca 62. Rregullore per Sigurimin e Cilesise.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVJ: Njësitë përgjegjëse të UAMD analizojnë dhe raportojnë periodikisht të gjithë të dhënat e marra nëpërmjet pyetësorëve të hartuar për studentët, stafit administrativ dhe akademik, si edhe për të gjithë veprimtaritë që ata zhvillojnë. GVJ sugjeron që vlerësimi të mos mbetet vetëm tek pyetësorët. Duhet një plan pune më i qartë me komponentë të tjerë vlerësimi jo vetëm për pedagogun por edhe për lëndën, për kurrikulën dhe për respektimin e standardeve nga pedagogu dhe studenti i këtij program studimi.</p> <p><i>Evidenca 62. Rregullore per Sigurimin e Cilesise.</i>  <i>Evidenca 15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ-ja ka sugjeruar përgjatë takimeve me njësinë bazë dhe NJSBC, bashkëpunimin dhe planin e punës vjetor me pika të mirë përcaktuara për sigurimin e cilësisë, duke filluar që me hartimin e planit të monitorimeve të përbashkëta, për pedagog, lëndë, syllabus dhe me trajnime nga NJSBC në fillim të vitit akademik për respektimin e të gjitha formateve të miratuara në rektorat që përkthejnë procesin mësimor në UAMD. Një pjesë të rëndësishme në punën e të dy njëjsteve do të ishte trajnimi apo informimi i pedagogëve në takime të grupuara nga njësia për respektimin e procedurave që duhen respektuar sipas kalendarit akademik.</p> <p><i>Evidenca 62. Rregullore per Sigurimin e Cilesise.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ shprehet se standardi është i plotësuar kryesisht, pasi NJSBC dhe</p>

	<i>njësia bazë duhet të shtojë në planin e punës vjetor, procedura të tjera përveç pyetësorëve të studentëve. Këta instrumente do të shërbejnë për një punë më efektive për sigurimin e cilësisë në UAMD. Për tu vlerësuar përpjekja e njësisë bazë dhe njësisë kryesore për përmirësimin e cilësisë.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Përkushtimi i drejtuesit të njësisë bazë dhe gjithë personelit akademik për ta mbajtur këtë program në nivel të lartë dhe pranë tregut të punës, si dhe për të ruajtur standardet e cilësisë, në mënyrë që aktiviteti mësimor dhe ai shkencor të zhvillohet sipas parametrave të kërkuar.
2. Komunikimi dhe bashkëpunimi shumë i mirë midis personelit akademik dhe studentëve është një pikë e fortë e këtij programi. E gjithë njësia bazë tregon një përkushtim të madh për të ndihmuar studentët dhe për t'i afruar ata me profesionin e së nesërme.
3. Zyra e projekteve në nivel institucional është shumë aktive. Personeli akademik i këtij departamenti është përfshirë në shumë projekte me donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, gjë që i ka ndihmuar ata të sjellin në institucion përvojat më të mira akademike të kohës.
4. Falë marrëveshjeve që institucioni ka nënshkruar me institucione të tjera në disa vende, personeli akademik dhe studentët e këtij program kanë shumë mundësi për mobilitete në vende evropiane. Po falë këtyre marrëveshjeve, njësia bazë dhe njësia kryesore kanë arritur të realizojnë një program studimi në koherencë të plotë me tregun e punës.



**Pika të dobëta:**

1. Bashkëpunim jo shumë i fortë e NJSBC me njësinë bazë për të hartuar komponentë të tjerë monitorimi në shërbim të ruajtjes së standardeve të cilësisë (përveç pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e pedagogëve) [(Standardi VI.1/Kriteri 3)]
2. Paçka se vetë njësia bazë bën përpjekje shumë të mira për të ruajtur standardet e cilësisë, është ende i zbehtë mekanizmi i vlerësimit të drejtuesit ndaj personelit akademik. [(Standardi VI.3/Kriteri 3)]
3. Mungesa e trajnimeve të personelit akademik, për ruajtjen e standardeve të cilësisë. Trajnime që duhen realizuar nga NJSBC në bashkëpunim me njësinë bazë. [(Standardi VI.5/Kriteri 4) ]


**Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon që Komisioni i përhershëm për garantimin e cilësisë dhe NJSBC, edhe pse i ka të mirë përcaktuara detyrat në rregullore dhe statut, duhet ta zgjerojnë aktivitetin e tyre dhe të përcaktojnë një plan pune vjetor në bashkëpunim me njësinë bazë. Aktiviteti i tyre i përbashkët duhet të jetë më efektiv. Vlerësimi i pedagogut dhe sigurimi i cilësisë nuk duhet të mbetet vetëm tek pyetësi periodik i studentëve në rang institucional. Drejtuesit e njësive duhet të hartojnë plan monitorimi, kryesisht tek pedagogët e rinj në eksperiencë, në mënyrë që këta të fundit të vlerësohen jo vetëm nga studentët, por edhe nga drejtuesit e tyre.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program "Bachelor Communication and Digital Marketing" provided by the Higher Education Institution "Aleksander Moisiu Durres University"**

**Strengths and affirmations**

1. The commitment of the head of the core unit and all the academic staff to keep this program at a high level and close to the labor market, as well as to maintain quality standards, so that the teaching and scientific activity develops according to the required parameters .
2. The very good communication and cooperation between academic staff and students is a strong point of this program. The entire core unit shows a great commitment to helping students and bringing them closer to the profession of tomorrow.



3. The project office at the institutional level is very active. The academic staff of this department has been involved in many projects with national and international donors, which has helped them bring to the institution the best academic experiences of the time.
4. Thanks to the agreements that the institution has signed with other institutions in several countries, the academic staff and students of this program have many opportunities for mobility in European countries. Thanks to these agreements, the core unit and the main unit have managed to realize a study program in full coherence with the labor market.

#### **Weaknesses**

1. Not very strong cooperation of IQAU with the basic unit to design other monitoring components in the service of maintaining quality standards (except student questionnaires for lecturer evaluation) [Standard VI.1/Criterion]
2. Although the core unit itself makes very good efforts to maintain the quality standards, the evaluation mechanism of the leader towards the academic staff is still weak. [(Standard VI.3/Criterion 3)]
3. Lack of academic staff training, to maintain quality standards. Trainings to be carried out by IQAU in cooperation with the core unit. [(Standard VI.5/Criterion 4)]

#### **Recommendation**

1. The External Evaluation Group recommends that the Permanent Commission for Quality Assurance and IQAU, although the tasks are well defined in regulations and statutes, should expand their activity and define an annual work plan in cooperation with the core unit. Their joint activity should be more effective. Lecturer evaluation and quality assurance should not be left only to the periodic questionnaire of students at the institutional level. Heads of units should draw up a monitoring plan, mainly for new experienced lecturers, so that the latter are evaluated not only by students, but also by their leaders.
2. The permanent quality committee and IQAU in cooperation with the core unit should add to the annual action plan the training of lecturers (staff training for recognition of quality standards, academic obligations, syllabus, exam theses). In this way, these units will influence the continuous improvement of teaching and the study program itself.
3. The External Evaluation Group suggests a review of the way of evaluating knowledge no longer according to the regulation that organizes it at the institutional level, but adapting it to the nature of the study program. This suggestion is due to the fact that in the curriculum of this program there is a significant amount of subjects, the assessment of which knowledge can be better measured through practical work individually or in groups.



## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>